

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 254, Dhjetor 2024

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Shoqata Atdhetare "Dukagjini" uron popullin e Shkodrës dhe të Dukagjinit kudo që ndodhen, në Shqipëri dhe jashtë saj:

GEZUAR DHE PËR SHUMË MOT KRISHTLINDJEN DHE VITIN E RI 2025

Festa e lindjes së Jezusit, të na bëj që të kemi më shumë dashuri për NJERIUN, të kemi më shumë paqe dhe më shumë harmoni, në të gjithë marrëdhëniet tona, në familje, në punë dhe në bashkësi, në gjithë jetën tonë sociale e shoqërore. Ajo është e pafund! Asnjëherë të mos e kursejmë atë për njeri-tjetrin, sepse vetëm kështu do të punojmë më mirë, për jetën tonë, për qenien tonë të përbashkët. Jeta, Paqja dhe Dashuria në mes nesh, mbretëroftë përgjithmonë!

Banorëve të Njësisë Administrative Shalës, kudo që ndodhen shaljanët, ju urojmë festën e Shën Gjonit apotull, gëzuar dhe për shumë mot!

KRYETARI NDUE SANAJ

Realizimet e vitit 2024, bazë e rëndësishme për ecjen në realizimin e misionit të SHAD dhe programi për vitin 2025

Të nderuar anëtare e anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar miq të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar dukagjinas kudo ndodheni!

Në emër të Kryesisë së SHAD, ju informojmë mbi realizimin e programit për vitin 2024 dhe mbi programin e shoqatës për vitin 2025.

Detyra kryesore e Kryesisë ka qene vijimi i botimit të gazetës "Dukagjini".

Në XXII vjetorin e botimit të saj mbëriti në nxjerrjen e 254 numrave, që do të thotë, në 254 muaj nuk është ndalur asnjëherë në saj të punës së palodhur e mjaft të përgjegjshme të Redaksisë së gazetës dhe bashkëpunëtorëve të saj. Janë afruar te gazeta "Dukagjini" 653 autore të ndryshëm, me nga nje artikull deri me 270 artikuj, Prele Milani; 264 artikuj, Ndue Sanaj; 197 artikuj, Luigj Shyti; 186 artikuj, Lazer Kodra dhe 114 artikuj, Zef Nika, Roza Pjetri, 100 artikuj, Lulash Brigja 78 artikuj dhe të tjerë, gjithsejtë 3 477 artikuj të ndryshëm sipas objekteve kryesore: Për kulturë tradicionale dhe bashkëkohore 850 artikuj, Portrete 892 artikuj, Problematike 632 artikuj, Krijimtari nga tradita e bashkëkohorja 481 artikuj, Veprimtari të ndryshme 412 artikuj, Përshkrime historie dhe natyrore 371 artikuj, Për zhvillimin e arsimit 106 artikuj.

Te gjithë i falënderojmë për kontributin e tyre.

Gazeta "Dukagjini" nuk mund të botohej pa kontributin financiar të 107 mundësorëve nga 2 000 leke e deri në 1 550 000 leke, gjithsejtë 5 099 542 leke. Për vitin 2024 kane kontribuar: Sokol Ndreza, Gjon Markaj, Besim Progni, Lisander Kola, Zef Toka e Martin Ara, Agron Hasanaj, Mikel Kopsaj, Lezer Çardaku, Nikolin Gjeloši, Preke Kulla, Gjergj Kodra e Ndue Ftoni, me një kontribut financiar të përgjithshëm 246 000 lekë. I falënderoj për kontributin e tyre financiar dhe i uroj "Paçin e Dhënçin!"

Me 9 Mars 2024, në bashkëpunim me bibliotekën "Marin Barleti" promovuam punën hulumtuese, studiuës e shkencore, kryesisht në fushën e historisë, Dr. Mark Palnikaj, të cilin Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", e nderoj me titullin "Anëtar Nderi i Shqitës Atdhetare Dukagjini", me motivacion: "Për kontribut të veçantë në hulumtimin dhe promovimin e dokumenteve historike me vlera të larta kombëtare, në pasqyrimin e historisë së Pultit e të Dukagjinit dhe për bashkëpunimin e vijueshëm e të suksesshëm me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini"."

Falënderojmë mundësorin për përgatitjen e zhvillimin e kësaj veprimtarie z. Viktor Arrinaj!

Me 2 Prill 2024, ne qytetin e Pejës Heroina Marije Shllaku u përjetësua bronc.

Në ngurrimin e bustit te saj, nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", mori pjese N/

kryetari I saj, Prele Milani, anëtar i Kryesisë Kole Sukullari dhe veprimtaret Gjon Shtegu e gazetari Mark Gjeka. Në këtë veprimtari mbajti fjalën e rastit studiuesi, shkrimtari, poeti e publicist Prele Milani; u vu kunore prane busitit, në emer te shoqates Kole Sukullari e Gjon Shtegu.

Falënderojmë anëtarin e kryesisë, z. Kole Sukullari, që mundësoj pjesëmarrjen në këtë veprimtari!

Me 12 Prill 2024, Shoqata e miqësisë Kodove-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", "Zëri i vëllazërisë – 2024" na bashkoi këngëtarë, valltarë, veprimtarë e artistë nga trojet etnike. Në emër të Shoqatës mori pjese Ndue Sanaj – Kryetari; Roza Pjetri – N/Kryetarja; këngëtarja Viola Shqau – anëtare e kryesisë dhe Dash Steri, anëtar i shoqatës.

Në këtë veprimtari me propozim të Kryesisë së Shoqatës "Martin Dreshaj", Kryesia e SHAD ju dha titullin e nderit "Mirënjohja Mehmet Shpendi", për nënte dëshmorët e komunës së Istogut, që ranë në betejat e lavdishme më 12 prill 1999: Isemt Bicaj, Skënder Maraj, Abedin Derwishaj, Xhafer Haskaj, Xhafer Mehmetaj, Bujar Visoqi, Nezir Mujaj, Smajl Fetahaj dhe Izet Shatri, me motivacion: "Për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, vetëflijimin e jashtëzakonshëm në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e trojeve shqiptare dhe mbeten të pavdekshëm në altarin e Lirisë" Gjithash-tu u nderua dhe komuna e Istogut me emblemën e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me motivacion: "Për kontributin e dhanë në forcimin e lidhjeve në mesë trojeve etnike".

Falënderojmë ata, që na mundësuan të jemi pjese e kësaj veprimtarie, z. Dash Steri dhe z. Viktor Arrinaj!

Me datën 19 prill 2024, fshati Molle e krahinës së Shoshit kishte një ditë veçante. Ajo mbledhi banoret e vet dhe shpaloši një pjese të historisë së saj të lavdishme nëpërmes birit të vet, Mark Mhill Fushaz, të cilit u sollën eshtrat e tij nga Brukseli, në kujdesin e kushërinjve të tij, Zef e Dede Fushazi. për tu varrosur në vendlindjen e tij. Vprimtaria drejtohej nga Dom Anton Kodrari. Mori pjese dhe deputetja e Shkodres, zj. Gerta Bardeli.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", përcolli vlerësimin e saj nëpërmes fjalës mortore, kurorës pranë arkivolit dhe dhënien e titullit "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", pas vdekjes, me vendim nr. 282, date 15 prill 2024, me motivacion: "Për kontributin e dhanë për mbrojtjen e trojeve kombëtare, për mbështetjen e mërgatës shqiptare pa dallime feje, ideje e krahine dhe për dashurinë e madhe për vendlindjen".

Falënderojmë mundësorin e marrjes pjese në këtë ceremoni mortore, anëtarin e Kryesisë, z. Kole Sukullari.

Me datën 4 maj 2024, ora 12.00, në

Gjakovë, u inaugurua monumenti i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut në mes të një pjesëmarrje mjaft e madhe nga gjithë trojet Arbënore: Nga Arbëreshet në Italia, Shoqata "Vatra" nga Stambolli Turqia, Shka "Rapsha" nga Malësia e Mbishkodrës, Sh A "Dukagjini" Shkodër, Shka "Aromë Labërie", Patriotët intelektualë e të burgosurit Politikë nga Ilirida, Estrada e muzikës kombëtare: Shkurte Fejza, Ilir Shaqiri, Nikollë Nikprelaj, Kastriot Tusha, Enkelejda Arifi, Selami Kolonja, Kristë Lleshi, Fatime Kalimashi, Malësorë Prenkoçaj e të tjera e të tjera personalitete të shquara nga vendi e diaspora. Nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini" mori pjese Ndue Sanaj, Gjergj Leqeja, Kole Çardaku e File Moshqeti.

Falënderojmë mundësorin, z. Gjergj Leqeja, N/kryetari i SHAD, që na mundësoj të jemi pjese e kësaj veprimtarie inauguruese!

Me 6 maj 2024, në Institutin Albanologjik në Prishtinë, nën drejtimin e shoqatës "Kufijtë e Arbrit", "Lëvizjes Shqiptaria" dhe "Lëvizja e Deçanit?", u kremtua datëlindja e kryeheroit kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeut, për të cilën u mbajt simpozium shkencor për veprën dhe historinë e lavdishme që la vulë të pashlyeshme nder breza, me teme: "Gjergj Kastrioti, figura përbashkuese e kombit shqiptar".

Në këtë simpozium me ligjërata të veçanet u paraqit edhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini", në të cilën kryetari Ndue

Sanaj dhe znj. Dukate Bregu, mbas përsëritjes filloi fjalimin me fjalët: "Ky organizim, në analizën tonë, është tepër i veçantë, veçanërisht nga tema e saj "Prezantimi i jetës dhe veprës së heroit tonë gjithëkombëtar Gjergj Kastrioti", është mjaft e gjetur në kohë, që do të thotë, ka ardhur koha të themi "Kushtrimi i Gjergj Kastriotit!", se duhet një personalitet kombëtar, rreth të cilit të bashkohet gjithë kombi shqiptar".

Në këtë veprimtari shkencore dhe ne koncertin madhështor Shoqata Atdhetare "Dukagjini" u paraqit me këngëtarë: Gentian Gropa, Noel Pjetri, Viola Shqau, Gjon Kosteri, Kole Hasanaj, Gege Zefi e të tjerë.

Falënderoj të gjithë pjesëmarrësit, që mundësuan me forcat e veta të jene pjesëmarrës në këtë veprimtari mbresëlënëse!

Me datën 11 maj 2024, në sallën "Mikel Koliqi", me muzikë me motive dukagjinas filloi veprimtaria festive kushtuar nxënësve të dalluar të klasës së IX dhe maturanteve dukagjinas, në kuadrin e 21 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Në këtë veprimtari u lexuan emrat e nxënësve te dalluar të klasës IX:

- Shkolla 9 vjeçare "Mehmet Shpendi", në Breg Lumi: Lisjano Pepniku e Emanuel Fusha;
- Shkolla 9 vjeçare në Pult-Shosh: Arsida Koçeku;
- Shkolla 9 vjeçare "Vasil Shanto", në Vrakë: Donald Marku e Angjela



Marku:

- Shkolla 9 vjeçare "Tring Smajlja", në Grude të Re: Martina Rrgalla;
- Shkolla 9 vjeçare "Dede Gjon Luli" në Hot të Ri: Andrea Kola e Aldo Malshyti;
- Shkolla 9 vjeçare në Bardhaj: Nevila Shkrepaç e Silvana Kamdaçaj;
- Shkolla 9 vjeçare "Branko Kadia" në Shkodër: Kristina Ndou, Estela Shpella, e Adriana Kroni;
- Shkolla 9 vjeçare "Edith Durham" në Shkodër: Nosh Dardhaj, Ermelinda Dardha, Tome Nika e Artenisa Nika;
- Shkolla 9 vjeçare "Zemra e Krishtit" në Shkodër: Emanuel Sukaj, Artea Lamthi, Sonia Kulla e Gerta Gjeloishi;
- Shkolla 9 vjeçare "Dëshmorët e Prishtinës", në Shkodër: Ritvan Pishinza;
- Shkolla 9 vjeçare "Cor Jesu", në Shkodër: Amarildo Pylla, Lorenzo Dajcaj, Florjan Deda e Rosela Gropaj;
- Shkolla 9 vjeçare "Miqësia" në Shkodër: Greisi Kakçuku e Lorenc Çallaku;
- Shkolla 9 vjeçare "Maria Ndihmëtare", në Shkodër: Laura Shkoza, Andrea Vata, Oksana Boka, Emanuel Shulza;
- Shkolla 9-vjeçare "Martin Camaj": -Sirodela Guri, Leandro Nika, Mateo Gilaj, Klaris Zhuri, Jonila Kullashi, Megi Shkambi, Sonila Molla, Klevis Suti, Erjon Kodra, Kolin Rrahi, Emanuel Shpatina, Salvador Bishaj, Andrea Lazri e Andrea Martijnaj.

Në emër të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" ju shprehim mirënjohjen për punën tuaj të dashur prindër, të nderuar mësues dhe për ju nxënës!

Në bashkëpunim me drejtorit e shkollave të mesme u evidentuan 16 maturant me origjinë nga Dukagjini, të cilët me vendim të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", nr. 283, date 16 prill 2024, ju dha titullit "Mirënjohja mësuese Kushë Micja", me motivacion: "Për paraqitjen e shkëlqyer në mësime, për edukatën dhe shembullin e mirë. Urojmë të jeni shtysa e përparimit në të gjitha fushat e jetës. Rezultatet tuaja bëjnë krenar familjen dhe bashkësinë e Dukagjinit. Në të ardhmen qytetaria tek ju të ketë zërin e rëndësishëm e përfaqësues në institucione, për të mbrojtur vlerat qytetare e duke i ngritur edhe më lart ato! Urojmë, që këto vlera të rriten, duke treguar dashurinë për traditën dukagjinase, kulturën dhe historinë kombëtare", të cilët janë:

- Shkolla e mesme "Mehmet Shpendi", në Breg Lumi (Shalë): Ardit Uka e Valantino Doçaj;
- Shkolla e mesme "Maria"- Don Bosco në Shkodër: Eugen Shkëmbi, Gladiona Shpati, Serxho Shpati, Xhozi Shpati, Desara Nika, Marina Grimaj, Elena Çobaj, Arber Plepi, Melisa Mirashi e Pamela Mirashi.
- Shkolla e mesme profesionale "Arben Broci", në Shkodër: Valerio Doçaj e Gentian Dreni;
- Shkolla e mesme profesionale pyjore, në Shkodër: Klodjana Gështenja e Griselda Sokoli.

Me titullin "Mirënjohja Mësuese Kushë

Micja" nderohet Kryetari i Sindikatës së Arsimit në Republikën e Kosovës, mësuesi Rrahman Jashari, me motivacion: "Mësues i përkushtuar dhe drejtues prej shumë viteve ku ka spikatur vazhdimisht me arritjet dhe ka sjellë ndryshimin në institucionet arsimore ku ka punuar"

Kryesia e SHAD nderon me titullin "Mirënjohja Martin Camaj" poetin e studiuesin Ndreke Dede Guri, me motivacion: "Për kontribute të shquara në evokimin e ngjarjeve historike të zonës së Dukagjinit në shekullin e XX; për pasurimin 21 vjetori i themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

Me vendim të Kryesisë nr. 283 date 16 prill 2024, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" vendosi të nderoj me tituj nderi disa personalitete, që me punën e tyre janë vlera të Dukagjinit:

*Don Nikë Ukgjini me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me motivacion: "Për kontributin e dhanë në drejtim e ri-ngritjes shpirtërore dhe intelektuale të besimtareve katolikë dhe jo vetëm, në vendin tonë dhe më gjerë si dhe në rizbulimin dhe promovimin e vlerave më të mira njerëzore, tradicionale dhe kulturore të popullit tonë; për devocionin e spikatur fetare si dhe pasionin për historinë, kulturën dhe traditën tonë kombëtare".

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me vendim nr. 283, datë 16 prill 2024, nderoi me titullin e lartë "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini" disa nga kadro ushtarake, që kanë punuar gjatë në zonën e Dukagjinit, ku kane kaluar një pjesë të rinisë së tyre: Kolonel Pajtim Ribaj, N/Kolonel Aleksandër Haxhia dhe Major Mynyr Gojashi, me motivacion: "Në moshën më të bukur të rinisë tuaj ja dhuroat një pjesë të saj malësorëve të Dukagjinit, të cilët ju respektuan, sepse i respektuat, aq sa edhe sot, pas shumë vitesh, që jeni larguar ju kujtojnë me respekt e dashuri. Kuadro si ju i bëjnë vend vetes, por dhe mbeten të gdhendur në mendjet dhe zemrat e tyre. Faleminderit për punën dhe përkushtimin tuaj, faleminderit për lidhjen e qëndrueshme me ne malësorët dukagjinase. Ne, malësorët e këtyre anëve, dhe veçanërisht brezi me të cilët punuat, ju do t'ju kujtojnë përherë me shumë respekt".

*Kryesia e SHAD, nderoi këngëtarën Viola Shqau, kryetare e seksionit të SHAD për artin e kulturën, me titullin "Nderi e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me motivacion: "Për kontributin e rëndësishëm të dhanë në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" nëpërmjet përgatitjes e realizimit të veprimtarive të Shoqatës, në veçanti në fushën e artit e kulturës. Kontributi i saj i gjithanshëm në familje, shoqëri dhe skenën e artit mbetet shembull dhe frymëzim".

*Kryesia e SHAD, gjithashtu me ketë rast nderoj me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini":

*Zonjën Sose Dedë Gështenja (Ahi), pas vdekjes, me motivacion: "Për kontributin e palodhur 40 vjeçar në fushën e shëndetit publik. Një nga bluzë bardhat më të hershme në Dukagjin; punëtore e pasionuar për kujdesin shëndetësor të banoreve të fshatrave të Shoshit, Toplanë dhe Rrethinave të Shkodrës, luftëtare

e palodhur për higjienizimin e baneve; aktiviste për pjesëmarrjen e femrës dukagjinase në veprimtaritë shoqërore, kulturore e artistike dhe për rolin e nënës në edukimin e familjes së saj"

*Zotin Kole Sukullari, kryetari i seksionit të Shoqatës për ekonominë, me motivacion: "Për. kontributin e tij të rëndësishëm në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" nëpërmjet organizimit dhe realizimit e veprimtarive, në të gjitha hapësirat shqiptare; frymëzim për dukagjinast për t'u bërë pjesë e Shoqatës dhe për të kontribuar në përgatitjen e marrjen pjesë në veprimtaritë e Saj"

* Zotin Gegë Zefi, veprimtar, me motivacion: "Për kontributin e vijueshëm në ndërtimin e veprave të mëdha infrastrukturore të atdheut, duke kenë edhe drejtues shumë kohorë; për ruajtjen dhe përhapjen e traditave kombëtare, që në moshe të re dhe deri në ditët e sotme, në veçanti nëpërmjet folklorit" *Kryesia e SHAD, nderon me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini" dhe tre artiste, të cilët janë dhe anëtar të Shoqatës, janë e ardhmja e folklorit Dukagjinase, të cilët po japim në vijimësi një shembull shumë të mirë bashkëpunimi mes veti dhe bashkëmoshatarëve të tyre, Gentjan Gropa, Bledar Hysenaj e Noen Pjetri, me motivacion: "Për kontributin në veprimtaritë e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për vlerat e tij artistike në interpretim".

Një falënderim i veçantë për ata, që na mundësuan financiarisht të përgatisim e të zhvillojmë ketë veprimtarë: Dede Prendaj, Gjin Markaj e Ndoc Sukaj, me banim në Nju-Jork; Sokol Sterbyqi, Preke Gjonaj, Arben Pepa, Beskin Arinaj, Nikoll Gerla e Ndoc Bregu, me banim në Kanada; Mhill Shkami, Anton Kosteri e Agron Hasanaj, me banim në Shkodër. Paçin e dhënçin!

'

Më datë 10 qershor 2024, në mjediset e Bibliotekës "Marin Barleti", Shkodër, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në bashkëpunim me Drejtorinë e Bibliotekës "Marin Barleti", Shkodër, organizoi promovimin e librit me titull "Flas me shpirtin tim", në të cilin morën pjesë të afërm, nënkryetare e Bashkisë Shkodër, zj Teuta Shala-Qyteza, intelektualë, profesionistë të fushave të ndryshme e të tjerë të interesuar ndër ta edhe të rinj e të reja me aftësi ndryshe të Shoqatës "Projekti Shpresa".

Autorit të librit, z. Tonin Arrinaj ju dha tituli "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me motivacionin: "Për kontributin e veçantë të dhanë nder vite në mbështetje të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"; për krijimtarinë e spikatur letrarë, një vlerë e çmuar e trashëgimisë tonë kulturore e artistike; për shembullin e mirë, që pasqyroni ju dhe familja juaj, me cilësitë më të mira të dukagjinast e qytetarit"

Mundësoi N/kryetari i këshillit të Shoqatës, z. Viktor Arrinaj!

Me 9 korrik 2024, me rastin e përvjetorit të vdekjes së Gjelo Shqau dhe me ketë rast u nderua me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me motivacion: "Për ndjenjën të larta patriotike dhe kontributin e vijueshëm për rikthimin e jetës normalë në trojet e të parëve të Dukagjinit, me iniciativë familjare ideuan dhe realizuan disa projekte në infrastrukturën e krahinës së Pultit; një nga organizatorët e protestave dhe petitionit për rrugën e Dukagjini në pranverën e vitit 2024, dha jetën aksidentalisht në rikonstruksionin e rrugës automobilis-



tike të Planit”

Mundësoi N/kryetari i këshillit të Shoqatës, z. Viktor Arrinaj!

Me 28 korrik 2024, u mbajt Dita e Plisit edicioni XI, faza e tretë, në Oden e gjen-eralëve Shaban e Bedri Shala, në fshatin Gjergjicë, komuna e Drenasit.

Në orët e hershme të mëngjesit Plisbardashët ia kishin mësy fshatit Gjergjicë komuna e Drenasit, çdo gjë ishte përgatit për ti prit miqtë plisbardashë.

Nga shoqata Atdhetarë “Dukagjini”, mori pjese: Ndue Sanaj, Kole Çardaku, Lulash Brigja dhe Lulash Gjeloşi – Martini.

Me propozimet e Kryetarit të Plisëbardhëve, z. Ismet Krasniqi-Lala, Kryesia vendosi, me vendim nr. 287, date 20 korrik 2024 nderoj:

a-Çifti Fehmi e Xheve Lladrovci, të nderohet me titullin “Mirënjohja Mehmet Shpendi”, pas vdekjes, me motivacion: “Për sakrificë të madhe, duke dhanë jetën për liri çifti Fehmi e Xheve Lladrovci, të cilët ranë heroikisht në luftën e UÇK-së për çlirimin e Kosovës. Jeta dhe vepra e tyre, u bënë simbol i sakrificës së dashurisë për Atdhe. Lavdi!”

b- Gjeneral Shaban Shala, të nderohet me titullin “Mirënjohja Mehmet Shpendi”, pas vdekjes, me motivacion: “Për kontribut të shquar për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb; për trimëri të spikatur në drejtimin strategjik në funksionin e komandantit, strateg i suksesshëm i UÇK-së gjatë luftës për liri. Jeta dhe emri i tij frymëzim dhe krenari për brezat. Lavdi!”

c- Habib Morina, të nderohet me titullin “Mirënjohja Mehmet Shpendi”, pas vdekjes, me motivacion: “Për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së, pjesëmarrës aktiv dhe komandant i nderuar; shembull frymëzimi në detyrën e komandantit të parë i stacionit të Policisë në Klinë, në Kosovën e lirë. Do ta kujtojmë gjithmonë me nderime për guxim, trimëri dhe aftësi drejtuese”.

d- Ymer Elshani, të nderohet me titullin “Mirënjohja Martin Camaj”, pas vdekjes, me motivacion: “Ju dhe familja juaj mbeteni simbol krenarie i luftës Çlirimtare për liri; për kontributin e dhanë në fushën e shkollimit, letërsisë dhe rezistencës kundër okupatorit serb. Kjo familje u flijua nga barbaria serbe, me gjyshin, babën, nenën, dy vëllezërit e pjesëtarët e tjerë të familjes. Lavdi!”

e- Marin Sopi, të nderohet me titullin “Mirënjohja Mësuese Kush Micja”, me motivacion: “Për kontributin tuaj të shkëlqyer si reporter dhe luftëtar i shquar gjatë sakrificës kombëtare për liri. Për punën tuaj shumëvjeçare si atdhetar i flaktë dhe mësimdhënës shembullor në edukimin e brezave”

f- Rapsodin Nazmi Hajdari, të nderohet me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, me motivacion: “Për kontributin dhe mesazhin të shkëlqyer të dhanë si rapsod në veprimtaritë kulturore në nivel kombëtare, pjesëmarrës i nderuar në manifestimet “Dita e Plisit” nder vite”.

g-Komuna Drenas, të nderohet me dhurimin e Logut të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me motivacion: “Për mbështetjen e vijueshme të veprimtarive kulturore, artistike me karakter kombëtar, në veçanti të shoqërisë civile, për të reali-

zuar misionin e tyre. Komuna e Drenasit simbol i luftës për liri”.

Falënderojmë mundësorët, që na mundësuan pjesëmarrjen në këtë veprimtari z. Gjergj Lqejza dhe z. Lulash Gjeloşi – Martini.

*Me datën 14 shtator 2024, ditë e shtune, në ora 10:30 Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në mjediset e bibliotekës “Marin Barleti” në Shkodër organizoi veprimtarinë me temë “Misioni i mësuesit”. Qëllimi kryesor i kësaj veprimtarie ishte të sensibilizojmë misionin e mësuesit, se mësuesi është prindër i dyte për nxënësin, është ai që i jep shkollim nxënësit, djalit po vajzës për jetën e tij, se vetëm shkollimi i jep atij mundësinë të eci në jetë.

Të pranishëm ishin Nënkryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Teuta Qyteza, zonja Briselda Kadia, Drejtoresha e drejtorisë së arsimit në Shkodër, zoti Edmond Tërthorja, Administrator i Universitetit Bujqësor Tiranë.

1-Në këtë veprimtari, me vendim nr. 288, date 5. 9. 2024, të kryesisë së SHAD, u nderuan me titullin “Mirënjohja mësuese Kushë Micja”, me motivacion: “Për kontributin tuaj të veçantë shumëvjeçare në edukimin e brezave me dije, kulturë dhe dashuri për vendlindjen. Ajo që ju keni dhënë qëndron dhe do qëndrojë në themelin e Kombit si investimi më madhorë për një shoqëri të emancipuar e bashkëkohore! Për bashkëpunimin të vijueshëm me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, në realizimin e misionit të saj”;

- mësueset:
- Shkolla 9 vjeçare në Pult-Shosh: -Gjelosh Kole Vata, Ndok Gjelosh Leka, Ndue Mark Kamdaçi, -Gjeline Pashko Demaj, Zef Marash Podi, Zojë Gjoke Vuksani;
 - *Shkolla 9 vjeçare në Prekal: Vate Doçaj;
 - *Shkolla 8 vjeçare në Shllak e Temal, ikë Kola;
 - *Shkolla 9 vjeçare “Vasil Shanto”, në Vrakë: Vitore Shqarri e -Vera Gjeloşi;
 - *Shkolla 9 vjeçare “Tring Smajlja” në Grude të Re: Gjyste Mark Lera;
 - *Shkolla 9 vjeçare në Bardhaj: -Kolë Larushku e -Roza Toka – Cara;
 - *Shkolla 9 vjeçare “Ndre Mjeda”, në Shkodër: Ermir Pal Lera, pas vdekjes;
 - *Shkolla 9 vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”, në Shkodër: Dukate Bregu;
 - *Shkolla 9-vjeçare “Martin Camaj”: Elena Marku e Gjon Podia;
 - *Shkolla e mesme profesionale “Arben Broci”, në Shkodër: Shuke Marku e Nesti Kiri;
 - *Shkolla e mesme “Oso Kuka”: Diana Ndreu;
 - *Shkolla 9 vjeçare “Cor Jesu”, në Shkodër: Rita Guri;
 - *Shkolla 9 vjeçare në Torovicë: Lula Bregu – Prroni;
 - *Shkolla e edukimit në Lezhë: Shpresa Ftioni;
 - *Shkolla 9 vjeçare në Gruemirë: Tringa Shtani;
 - *Shkolla 9 vjeçare në Melgushë: -Djella Lin Vuksani;
 - *Shkolla 9 vjeçare në Sterbeq: Martin Gjoni;
 - *Në SHBA: Vjollca Kapaj (Funiçi) e Marie Bregu;
 - Mësues në pension: -Prenda Gjon Sogja e -Dede Lulash Preka.

2- Në këtë veprimtari u nderuan me titullin “Mirënjohja mësuese Kushë Micja”, mësuesit, për kontribute të veçanta në mësimdhënie e drejtues, të disa prej tyre, jo dukagjinas:

a-Motër Michaela Kubickova, nga Çekia, murgeshe e urdhrit Seleziane, 25 vite në Shkodër dhe sot është në detyrën e Drejtoreshës Superiore e Shkollës jo publike “Maria Ndihmëtare”, në Shkodër ...,me motivacion: “Për kontributin shumëvjeçare në qytetin tonë në edukimin e brezave me kulturë bashkëkohore dhe besimin në Zot; për respekt dhe mbështetje të vijueshme ndaj prindërve, nxënësve dhe bashkësisë dukagjinas dhe për bashkëpunimin me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”; për shembullin tuaj pozitiv që pasqyroni ju dhe Qendra e juaj Edukative”

b-Zonja Alketa Karafili, drejtoreshë e shkollës 9 vjeçare “Martin Camaj”, në Shkodër, me motivacion: “Për kontributin shumëvjeçare në edukimin e brezave me kulturë bashkëkohore; për respekt dhe mbështetje të vijueshme ndaj prindërve, nxënësve e bashkësisë dukagjinas dhe bashkëpunimin me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”; për shembullin tuaj pozitiv që pasqyroni në shkollën 9 vjeçare “Martin Camaj”

c-Zonja Briselda Kadia, drejtoreshë e Zyrës Vendore të Arsimit, në Bashkinë Shkodër, me motivacion: “Për kontributin të veçantë në edukimin e brezave me kulturë bashkëkohore; për respekt dhe mbështetje të vijueshme ndaj prindërve e nxënësve dhe bashkëpunimin me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, në realizimin e misionit të saj; për shembullin tuaj pozitiv që pasqyroni në punën tuaj drejtuese në institucionin e shkollimit në bashkinë Shkodër”

d-Motër Ardiana Haxhari, drejtoresha e shkollës 9 vjeçare “Zemra e Krishtit”, me motivacion: “Për kontributin shumëvjeçare në edukimin e brezave me kulturë bashkëkohore dhe besimin në Zot; për respekt dhe mbështetje të vijueshme ndaj prindërve, nxënësve dhe bashkësisë dukagjinas dhe bashkëpunimin me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”; për shembullin tuaj pozitiv që pasqyroni në shkollën 9 vjeçare “Zemra e Krishtit”

e-Kadri Mehmet Ymeraj, ish mësues e drejtor shkolle, në fshatin Bruçaj, me motivacion: “Për kontribut të veçantë në

mësimdhënie në zonën e Dukagjinit, në veçanti në fshatin Sumë - Bruçaj, dhe drejtues i suksesshëm”

3- Në këtë veprimtari u nderuan me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”:

*Zonja Ledia Dushi, anëtarën e kryesisë se SHAD, me motivacion: “Poetja, përkthyesja e studiuesja e një përmase evropiane, që do e kishte lakmi pasaportën e Saj çdo vend i vlerave të larta artistike! Fatmirësisht, është zëri ynë, që na bën krenarë. Për kontributin e saj të vijueshëm në realizimin e Misionit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”

*Prof. Dr. Tonin Gjuraj, anëtarin e SHAD, Rektorin e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, me motivacion: “Krenari për të gjithë ne. Pasqyrë e vërtetë e intelektualit të mirëfilltë. I vetë-investuar në fushën më madhore të shoqërisë, në botën akademike! Shkëlqesë në udhëtimin diturorë, për të gjithë ne. Për kontributin tuaj të vijueshëm në realizimin e Misionit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”

*Zoti Edmond Tërthorja, anëtarin e SHAD, Administratorin e Universitetit Bujqësor Tiranë, me motivacion: “Për aftësitë e tij drejtuese në strukturat larta të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Është modeli i bashkëpunëtorit me pedagoget, studentet dhe bashkësinë e administratës në këtë institucion të rëndësishëm të shkollimit dhe shkencës të vendit tone, model i punës në realizimin e misionit të shoqatës atdhetare Dukagjini”

4- Në këtë veprimtari u nderuan me titullin “Anëtar Nderi të shoqatës Atdhetare Dukagjini”, kolonelin në pension Et’ hem Bardhi, me origjine nga Peja, që ka punuar në detyra të ndryshme në zonën e Dukagjinit e në zonën e Nënshkodrës, deri komandant Brigade të Këmbësorisë në Bushat, me motivacion: “Në moshën më të bukur të rinisë tuaj ja dhurovat një pjesë të saj banoreve të Shkodrës, dukagjinas e bregabunas, të cilët ju respektuan, sepse i respektuat, aq sa edhe sot, pas shumë vitesh, që jeni larguar ju kujtojnë me respekt e dashuri. Kuadro si ju i bëjnë vend vetes, por dhe mbeten të gdhendur në mendjet dhe zemrat e tyre. Faleminderit për punën dhe përkushtimin tuaj, faleminderit për lidhjen e qëndrueshme me ne banoret e Shkodrës, të cilët, në veçanti brezi me të cilët punuat, do ta kujtojnë pejanin përherë më shumë



respekt”.

5- Në këtë veprimtari u nderuan me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, sportistin e cilësisë së lartë të volejbollit dhe mësuesin e veçantë në shkollën 9 vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”, zotin Nikolin Qafarena, me motivacion: “Mësues i dalluar e sportist i cilësisë së lartë, me kontribute të veçanta për Shkodrën dhe Shqipërinë, duke u kthyer në një shembull frymëzimi dhe krenarie për bashkësinë dukagjinase. Për mbështetjen e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në realizimin e misionit tonë të përbashkët”

Një falënderim i veçantë për ata, që na mundësuan financiarisht të përgatisim e të zhvillojmë këtë veprimtari: Dede Prendaj, Gjin Markaj e Ndoc Sukaj, me banim në Nju-Jork; Sokol Sterbyqi, Preke Gjonaj, Arben Pepa, Beskin Arinaj, Nikoll Gerla e Ndoc Bregu, me banim në Kanada; Mhill Shkami, Anton Kosteri e Agron Hasanaj, me banim në Shkodër. Paçin e dhënçin!

Me 20 shtator 2024 u zhvillua veprimtaria e gjithëdijshëm e titulluar “Akademi Përkujtimore”, me një pjesëmarrje e shumtë, përshëndetjet e referimet nga më të vlerat të personaliteteve të artit e kulturës, prania e drejtuesve vendorë të Malësisë së Madhe e të Qarkut Shkodër, të mediave lokale, rajonale e kombëtare si dhe financimi e impenjimi maksimal i “Miqve të Sali Mani në Amerikë”, me në krye të nderuarit bashkëmalësorë Luigj Gjokaj e Ndue Gjekaj, që e vendosën Këngëtarin e Madh, Sali Mani përjetësisht në Altarin e Kulturës së Kombit Shqiptarë, aty ku janë e do mbetën gjithmonë korifenjtë që dhanë në çdo kohë gjithçka për trojet tona e më gjerë.

Në këtë veprimtari morën pjesë: Ndue Sanaj, Prele Milani, Viola Shqau, Kole Çardaku, Gjon Kosteri e të tjerë.

Me vendim të Kryesisë së SHAD, nr. 289, date 18. 9. 2024, Rapsodi Sali Mani, u nderua me titullin “Anëtar Nderi I Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, me motivacion: “Jeta e tij ishte një libër krenarie në shërbim të Artit, Kulturës dhe në veçanti të Folklorit, duke nderuar Malësinë e Madhe dhe krejt Shkodrën. Artist me vlera të larta kombëtare, që la një trashëgimi të çmuar artistike për brezat”, dhe ju dorëzua nipit të tij, z. Sytki Ndreca nga Kryetari Ndue Sanaj dhe drejtuesja e sektorit të artit e kulturës pranë kësaj shoqate, këngëtarja Viola Shqau (Podja).

Mundësoi pjesëmarrjen z. Kole Çardaku, zj, Viola Shqau, z. Prele Milani e Gjon Kosteri.

Me 12 tetor 2024, në një vjetorin e ndarjes nga jeta të Zef Frrok Perndreu, i cili një vit me pare u nda nga jeta aksidentalisht, duke punuar në rrugën e Dukagjinit. Me këtë rast, Kryesia e SHAD, me nr. 290, date 9. 10. 2024 i jep titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, pas vdekjes, me motivacion: “Në respekt të punës dhe jetës tuaj që u fljuat në Trojet e Dukagjinit, duke punuar në rrugën e Dukagjinit. Vëlla i dashur Mirditor ju ishit shembull i burrnisë dhe respektit për të gjithë ata që të kanë njohur dhe punuar me Ju. Bashkësia Dukagjinit jeton me dhimbjen e familjes suaj, sepse Ju do të jeni gjithmonë “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”

I përjetshëm qoftë kujtimi juaj!”

Mori pjesë Ndue Sanaj, Kole Çardaku, Prele Shytani dhe Kole Sukullari.

Mundësoj pjesëmarrjen z. Kole Sukullari!

Më 27 Tetor 2024, zona malore e Shllakut mirëpriti rreth 500 pjesëmarrës në Festën e Gështenjave, një veprimtari, që tashmë po kthehet në traditë, që jo vetëm promovon pasurinë kulturore të zonës, por edhe forcon lidhjet mes banorëve dhe vizitorëve.

Nga SHAD morën pjesë Ndue Sanaj, Prele Milani, Gjon Shtegu, Viola Shqau, drejtuesja e programit artistike, Prele Shytani, Gjon Kosteri e të tjerë.

Me këtë rast, me propozim të Famullitarit të Famullisë së Shllakut, Dom Marjan Gjinesha, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me vendim nr. 291, date 20. 10. 2024, nderoi me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, organizatorët, të përkushtuarit në organizimin, përgatitjen e zhvillimin e festes së “Gështenjës”, në Shllak, fshatin Ukbibaj, Mark Gjeka, Miran Pali, Kristjan Ndoja dhe Nikolin Shqau, me motivacion: “Një nder organizatorit e Festës së “Gështenjës” në Shllak, për përkushtimin dhe punën tuaj në promovimin e zonës. Falë kontributit tuaj të çmuar, kjo festë është kthyer në një mundësi të shkëlqyer për të bërë të njohura traditat dhe bukuritë e krahinës së Shllakut, duke nxitur vlerat kulturore dhe natyrore të këtij vendi. Mirënjohjeje të thellë për rolin tuaj në forcimin e bashkësisë dhe promovimin e pasurive tona”.

Falënderojmë mundësorët në pjesë-

marrjen në këtë festë, biznesmeni Nikolin Shqau dhe Gjon Shtegu!

Më datë 10 nëntor 2024, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” në bashkëpunim me Qendrën Rinore “Arka” organizuan veprimtarinë promovues të librit “Bukuria e Kristinës”, roman i autorit, z. Engjëll Gazhdaj. Kjo veprimtarie e mbajtur në qytetin tonë, mbledhi artdashës dhe anëtarë të bashkësisë, përfshirë 18 të rinjtë e Klubit të Librit të Shoqatës “Projekti Shpresa”, si dhe median lokale, të cilat pasqyruan veprimtarinë, duke theksuar rëndësinë e promovimit të kulturës dhe letërsisë në zonën tonë.

Veprimtaria u mundësua nga vete autori i librit, z. Engjëll Gazhdaj.

Me 23 nëntor 2024, u zhvillua veprimtaria për paraqitjen e librave “Shqiponjat e Ballkaniadës 1946” dhe “Babagyshat e Kombëtares” të autorit Prele Milani, në mjediset e Stadiumit të Futbollit “Loro Borici”, me një pjesëmarrje të jashtëzakonshme!

Me këtë rast Kryesia e SHAD, me vendim nr. 292, me 16. 11. 2024 u nderuan me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”:

1- **Klubi i Futbollit “Vllaznia”**, me motivacion: Nëna mbretëreshë, Mirusha hirplote e futbollit shqiptar. Amalthea e dashurisë magjike të lojës “top e këmbë”. Lokemadhja që lindi, ushqe, rriti, burëroi dhe ngjiti në malin e “Shenjtë” dhjetëra gjenerata legjionarësh historik. “Vllaznia” Dodona jonë shpirtërore, pikë referimi e vazhdimësisë futbollit shqiptarë. Madhështi e vatrës së vjetër, bukuri vegimtare ku ndizet flaka e re sportive nëpër të cilën përtërihen me gjak kampionesh virtytet e vjetra stërgjyshore. “Vllazni”, mbretëresha e zjarrtë e dashurisë. “Vllazni” Kuq e blu, sot e nesër dhe përjetësisht zëmra jonë!

2- **Loro Borici**, me motivacion: Një pegas sugjestionues i mbuluar kokë e këmbë me dafina epitetesh të shkëlqyera, i larë nga një shi i artë metaforash të shndritshme, i veshur me hiperbolat e një sovranit gjithë prestigji në fronin e tij vetmitarë.

3- **Anton Mazrreku**, me motivacion: Një rilindës i shquar i sportit, i pa harruar, i pa imitueshëm. Themelues i gazetarisë sportive radiofonike i cili më penën mikrofonin e tij ndezi në terrenin sportiv shqiptarë pishtarin e flakës olimpike

4- **BESNIK DIZDARI**, me motivacion: Emblema, enciklopediku, dashuria, vëzhgimi, gjurmimi, fiksimi sentenca,

këndimi, promovimi, kujtesa lapidare e gazetarisë sonë sportive. Besnik Dizdari, babai dhe pika mbi i e Historisë së futbollit shqiptarë

5- **Hilë Staka**, me motivacion: Atlet, notarë dhe futbollist i shquar. Që me 1925 anëtarë ekipit simpatik “Malet tona”, pastaj “Student Shkodra”. Themelues dhe titullarë gjurmë-lënës i “Bashkimi Shkodranë” në vitet 1930-1935 dy herë nën kampion kombëtarë. Student i shembullor i Fakultetit mjekësor në Universitetin e Bolonjës vdiq pa prituri në vitin 1936. U shua si trëndafil që e rrafshon shtrëngata, por emri i mbeti në historinë e etërve të futbollit shkodranë.

6- **Artisi i Popullit Pjetër Gjoka**, me motivacion: Në rini u dallua si futbollist, atlet natarë dhe alpinist. Ishte nja nga gurët themeltarë të Bashkimit Shkodranë me 1930, mbrojtës i djathtë me numër katër. Luftëtarë “Liburnës” historike, deri sa në vitin 1933 një ndërhyrje brutale e qëllimshme e një malazezi në Podgoricë e nxori përgjithmonë nga fushat e blerta. Shkodra e futbollit humbi një luftëtarë të orëve të para, por fitoj një aktor të niveleve më të larta të arit shqiptar.

7- **Profesor Luigj Shala**, me motivacion: Njeriu universal, i ushtrimit, drejtimit, studimit dhe gjykimit të sportit Shqiptarë. I dalluar mes më të daluarve të Bashkimit Shkodranë. Organizator dhe themelues i Kombëtares së Shqipërisë me 12 mars 1936. Kampion kombëtarë atletike, pjesëmarrës në tri olimpiada ndërkombëtare ballkanike në Athinë Zagreb dhe Stamboll. Shqiptari i parë që merre një medalje ndërkombëtare të bronxët në Stamboll. Bilbili i ynë i parë ndërkombëtar që daton në korrik të vitit 1937. At i alpinizmit shqiptarë dhe studiues i mirënjohur i etnografisë.

8- **Dodë Tahiri**, me motivacion: Babagyshi i portierëve kombëtare, nxënës i shkollës jugosllave të futbollit. Si asnjë shkodranë tjetër i portës dy here radhazi Kampion kombëtarë fitues i Kupës e ushtrisë kombëtare, Kampion kombëtarë në hedhje gjyle, Kampion Ballkanit. Portier kombëtarë jo vetë Shqipërisë por dhe Malit të Zi. Tahiri i përket emrave të privilegjuar, të pajisur me një rini të përherëshme, ndaj historiani e studion, patrioti e lëvdon, trimi e nderon, specialisti i futbollit e çmon, rapsodi e këndon dhe tifozi nuk e harron

9- **Prekë Gjeloshi**, me motivacion: Një individualitet i spikatur një talent i veçantë në kolorin e asaj kolonie ku Shkodra pati diell kampionesh më shumë se kush do tjetër në Shqipëri. Vëlla i Bashkimit Shkodranë “Vllaznisë” dhe “Punës” gjithmonë besnik i Shkodrës. Babushi mbeti gjithmonë kuq e blu Luftoi me shpatën ngjeshë më “Spartakun” e Moskës, “Hajdukun”, “Splidit”, “Budiçnostin”, “Cervena”, “Zvezdën”, me Përfaqësues e Malit të Zi e të tjera.

10- **PAL MIRASHI**, me motivacion: Çdo kush që tenton të shfletojë historinë e futbollit shqiptarë është i “dënuar” të përballet me portretin e mjeshtrit të racës kampione Palë Mirashi. Zbulimi i madh i 1946, Kampion dhe nën kampion i Ballkanit, Kampion te Vllaznia e Dinamo, i dashur dhe gjurmëlënës te Tirana e pa fat.

11- **Simon Deda**, me motivacion: Pinjoll i familjes së mirënjohur tregtare të Shan Dedë Jakupit më rrejë nga fisi i Du-



shmanit. I Madh në mesin e me të mëdhenjve. Sulmues grabitqarë i demave të kuq, fitues i 5 titujve kampion kombëtare, heroi i Lajpcigut, flutura e fushave të blerta të futbollit, emblemë e Partizanit emblemantik, legjionar i Kombëtares, senatorë i futbollit tonë.

12- **Lin Shllaku**, me motivacion: Produkt i kombinatit Shkodra futboll. Kapiteni i madh i kombëtares dhe Partizanit, mëlçia frymë dhënëse ekipit. Mesfushorë me intuitë që parashikonte çdo lëvizje me top e pa top. I pa gabueshëm taktikisht, mjeshtër i pasimit goditës me dy "patllake". Kapedan me shtatë nishane shtatat kampionate kombëtare. Fitues i Kupës Ballkanike mes Klubeve. Kapiteni Lin Shllaku dhe armata jonë kuq e zi, i preu rrugën Irlandës së Veriut për në Botërorin e 1966 dhe RFGJ për Evropianin e 1968 -ës.

13- **Nikollë Gjergji** i "Luftëtarit" dhe "Vllaznisë", me motivacion: Kampion atletik në garën 110 metrave për të rijë, Kampion për rinj në Volejball, fitues i Kupës së Shqipërisë me 1965. S'printe i shkëlqyeshëm që tmerronte mbrojtësit, bombardues i saktë dhe nuhatës i zoti i portës Anëtarë i ekipit kombëtar Shpresa. Talenti i tij u shua në Konstancë, një thyerje këmbë e largoi aksidentalisht nga futbollit, ndonëse pranë futbollit qëndroi gjithë jetën, pranë ekipeve të moshave dhe të rinjve të "Vllaznisë".

14- **Çesk Ndoja**, me motivacion: Simpatikun i heshturi dhe punëtori i pa lodhur i "Vllaznisë" mbretërore të viteve shtatëdhjetë. Një nga mesfushorët djathtë më të shquar të kohës, por edhe sulmues ekstrem. Luajti për "Luftëtarin" dhe "Vllazninë". Pas 26 vitesh "Vllaznia" e Çesk Ndojes ngjitet në majat e futbollit shqiptarë, me 1972 rrokur me kupe e kampionat dhe 1974 kampione. Lojtarë i ekipit kombëtarë shpresa që politika e zbriti nga autobusi

15- **Agustin Kola**, me motivacion: Çun Tirane, me gjak shkodrani dhe karakter të fortë dukagjinasi, me motivacion: Direktori Kola - Minga dhe senatori tiranas, rrëzuan dhe shemben për dhe Kalifatin e kalifëve të kuq të "Partizanit" dhe sulltanatin "Dinamovit". Agustin Kola gjatë një karriere 20 vjeçare, 21 here u vesh kuq e zi, provoj të fitoj të gjitha trofetë e mundshme të futbollit tonë. Dinamiti i "Shkëndisë", "17 Nëntorit" dhe ekipit grek "Eglatos". Kishte karakterin e luanit në fushë, lojtarë që nuk dorëzohej kurrë.

16- **Nikolin Thana** "Mjeshtër sporti", me motivacion: Një nga mesfushorët më potenti i viteve tetëdhjetë- traktor, taktik, punëtorë, i pa lodhur dhe altruist. Doli nga fidanishtja e Shkollës së Mjeshtërisë Sportive. Ka luajtur për ngjyrat e "Shkëndisë", "Vllaznisë" dhe "Apolonisë", duke dhënë shpirtin në fushë. Ka kaluar hallkat ekipeve kombëtare, të rinjve dhe shpresave. Veç talentit dhe djersës së ballit nuk pati as një stimul, por vetëm pengesa e s' trekëmbështa Nga futbollit e ndau aksioni për rrëzimin e bustit të Stalinit duke përfunduar në burg si armik i popullit. Ndonëse krejt imponant mbetet pararendësi më autentik i lëvizjeve të nëntëdhjetës.

17- **Armir Grima**, me motivacion: Portieri më jetëgjatë i kuadratit shkodranë i veshur me uniformën e gardianit të ekipit të parë që në moshën 15 vjeçare. Ka luajtur për ngjyrat "Vllaznisë", "Dinamo",

"Partizanit", "E' thinkos" të Pireut e "Flamurtarit" të Prishtinës. Ka veshur fanelën e ekipit "Shpresa". Ka fituar të gjitha trofetë e mundshme kombëtare të futbollit shqiptarë, vazhdon të jetë aktiv pranë futbollit në detyrën e menaxher dhe trajner kombëtar i futbollit të femrave

18- **Marash Kumbulla**, me motivacion: Biri i një emigranti nga Dukagjini, lindur në Itali në vitin 2000 i shkëlqyer tek Verona i cilësuar si mbrojtës qendror me të ardhme të madhe. Roman i huazuar te Spanjoli, ka luajtur në të gjitha nivel ekipeve tona kombëtarë. Aktualisht titullar i defensivës tonë me 26 prezencë. I ledhatuar prej muzave e sukseseve rinore, i urojmë suksese drejt majave

19- **Mill Shkamë**, me motivacion: intelektual dhe njeri shembullor i sportit, bilbil me integritet të lartë në drejtësinë sportive shqiptare, që për gjatë viteve 1973-2003 ka gjykuar mbi 500 ndeshje futbollit. Nga viti 1996- (pyete) ka ushtruar me kompetence profesionale detyrën vëzhguesi FSHF të futbollit. Ka kryer për disa vite (pyete) detyrën e rëndësishme Kolegjiumit të arbitrave të Shkodrës. Si kryetarë i shoqatës sportive Profesor Luigj Shala është ideues dhe themelues i çmimit kombëtarë "Luigj Shala", duke zhvilluar dy edicione kombëtare në vlerësimin e bilbilave historik të futbollit tonë. Futbollit dhe arbitrimi janë binomi i jetës së inxhinierit ndërtues dhe aktivistit shoqëror Mhill Shkëmbi.

20- **Gabriel Kulla**, me motivacion: Në qiellin e futbollit latin po shfaqet një talent i ri shqiptar, duke hyrë në historinë e futbollit italian si lojtari me i ri 15 vjeç, që shënon në një ndeshje të rriturish. Gabriel Kulla po ecën i sigurte e po rritet nga dita ditës si sulmues më dhëna shkëlqyera me të ritë e Sansueloes. Shoshiano- Shkodrani 16 vjeçar i formacionit kuq e zi të U 17, dhe në nëntë ndeshje ka realizuar nën gola, secili e më i bukur e më rëndësishëm se tjetri PËR Shqipërinë e tij. Dita e mirë duket që në mëngjes! Gabrel kulla është ende në hapat e pare të karrierës, ndaj kjo mirënjohje le të jetë një bekim. U rritesh e u bëfsh shqiptarë e fushave të blera.

21- **Esmeralda Franja**, me motivacion: E shpejtë si era dhe luftëtare si Athenea. Mbrojtëse e hekurt, me karrierë të ndritshme, e cila me shiritin e kapitenes ka udhëhequr autoblindën kuqe e blu në fitimin e nëntë titujve kampion. legjionare e shquar në ditët plot diell, por edhe me acar e stuhi e ekipit tonë përfaqësues, në sfidat më të rëndësishme ndërkombëtare gjatë dhjetë viteve në Ligën e Kampioneve të Evropës, në eliminoret të Evropianit dhe Botërorit. Qëndron e vendosur dhe e sigurt si amazonë në majat e futbollit femërorë shqiptarë.

22- **Klubi i Futbollit "F C DUKAGJINI"**, në **Miçigan**, me motivacion: Në fillim të viti 1981 ish portieri i parë i Kombëtares Shqiptare edhe të Malit të Zi, Dodë Tahiri, në Detroit do të krijonte ekipin Futbollit "Vllaznia" me djem emigrantesh shqiptarë. 40 vjet me vonë, një tjerë djalë Dukagjini, Gentjan Zef Nonaj krijoi ekipin e futbollit "FC DUKAGJINI", në Miçigan. Skuadra simpatike rinore shqiptar, stërvitet, luan rregullisht dhe ka rezultate befasuese në futbollin amator në shtetin e Miçiganit. "FC DUKAGJINI" përbehet nga 24 lojtarë shqiptarë kryesisht nga Dukagjini i Shkodrës. Rrafshi i

Dukagjinit dhe Malësia e Madhe. I urojmë "FC DUKAGJINI", presidentit dhe futbollistit të talentuar Gentjan Zef Nonaj udhë të mbarë në gjurmët e etërve të futbollit shkodranë drejt majave më larta të futbollit!

Presidenti i Klubit të Futbollit "Vllaznia", z. Alban Xhaferri, nderoj z. Prele Milani, me fanellën, me mbishkrimin "Ballkaniada - 1946", me nr. 10 dhe për SHAD, me nr, 22.

Falënderojmë mundësorët e kësaj veprimtarie: Presidentin Klubit të Futbollit :Vllaznia.; z. Alban Xhaferri, z. Kolë Çardaku, z. Vitor Arrinaj, z. Mhill Shkambi, z. Prek Kulla e z. Gjon Shtegu, me shprehjen popullore: Paçi e dhënçi!

Presidenti i Klubit të Futbollit "Vllaznia", Alban Xhaferri, na dhuron nga një fanell të Kombëtares së vitit 1946, Preles, autorit të librit nr. 10, sulmues, që të vijojë e të vijojë në punën krijuese dhe nr. 22 SHAD,

të jetë gjithnjë ne prapavijë e të ushqej në vijimësi veprimtari sa më dinjitoze

Të nderuar anëtare e anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar miq të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar dukagjinas kudo ndodheni!

Në ketë vit, me mjaft realizime, kemi pasur dhe ndarje nga jeta të bashkëpunëtorëve të SHAD, madje bashkëthemeluesit e drejtues të saj:

Fran Vuksani, Voc Dedë Mjetaj, - Luigj Shyti, me 20 tetor 2024
me 16 prill 2024 me 12 gusht 2024

Pjetër Fran Geraj,
Ndue Mici,
me 29 tetor 2024
me 26 nëntor 2024

Ishin shokë të mirë, bashkëpunëtor të mirë, që gjatë do të kujtohen për përkushtimin e tyre në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Ngushëllojmë familjet e tyre, qofshin e ti kujtojnë!

I paharruar kujtimi I Fran Vuksanit, Voc Dedes, Luigj Shytit, Pjeter Geres e Ndue Micit!

E gjithë kjo veprimtari nuk mund të realizohej pa kontributin financiar të dukagjinasve kudo ndodhen, të cilët paraqiten më poshtëm:

1. Sokol Ndrezaj	20500 leke
2. Nikolin Gjeloishi	220 euro
3. Gjin Marrkaj	500 dollare
4. Ndco Sukaj	300 dollare
5. Lisander Kola	200 dollare
6. Dede Prendaj	300 dollare
7. Arben Pepa	200 dollarë
8. Sokol Sterbyqi	200 dollare
9. Preke Gjonaj	200 dollare
10. Besnik Arrinaj	200 dollare
11. Nikoll Gerla	100 dollare
12. Ndoc Bregu	100 dollare
13. Klodjaa Serraj	5000 leke
14. Besim Progni	20500 leke
15. Vikto Arrinaj	85000 leke
16. Zef Toka	10000 leke

17. Martin Arra	10500 leke
18. Agron Hasanaj	20500 leke
19. Gjergj Leqejza	35000 leke
20. Mikel Kopsaj	20500 leke
21. Lazer Çardaku	20500 leke
22. Kole Çardaku	81 000 leke
23. Mhill Shkami	30 000 leke
24. Anton Kosteri	10 000 leke
25. Kole Sukullari	5 000 leke
26. Nikolin Shqau	5 000 leke
27. Preke Kulla	30 500 leke
28. Gjon Shtegu	10 000 leke
29. Gjergj Kodra	20 500 leke
30. Mark Mici	10 000 leke

Shuma e përgjithshme, është 450 500 lekë, 220 euro, 1 300 dollarë dhe 1 000 dollarë kanadez.

Nga kjo shumë, 246 000 leke janë shpenzuar për botimin e 12 numrave të gazetës "Dukagjini" për vitin 2024, nga numri 243 (muaji janar 2024) e deri në numrin 254 (muaji dhjetor 2024). Pjesa e tjetër është shpenzuar për organizimin, përgatitjen e zhvillimin e veprimtarive të shoqatës dhe për pjesëmarrjen në veprimtaritë e tjera sipas ftesave që i janë bërë shoqatës.

Të gjithëve ju falënderojmë për kontributin tuaj financiar shumë të çmuar, që brezat do të jenë shumë krenar për kontributin tuaj. Gjithmonë paçi e dhënçi për mirë!

Njëkohësisht falënderojmë të gjithë miqtë, bashkëpunëtorët që na kanë mbështetur me mjete për të lëvizur nga një rajon në tjetrin, nga një vend në tjetrin, me shpenzimet e tyre!

Kjo punë e këtij viti është një bazë nisje për punë më të plota për vitin 2025, për punë më të mirë në realizimin e MISIONIT të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Mbështetur në arritjet e këtij viti, në vitin 2025 do të punohet me ketë program:

1-Vijimi i botimit të gazetës "Dukagjini", me 16 faqe, e vijueshme, Redaksia.

2-Studimi mbi vijimin e shkollimit të fëmijëve në zonën tonë, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të Rajonit, dhe propozimi i masave konkrete strukturave përkatëse, për ndryshimin e gjendjes, qershor-korrik 2025, Seksioni i shkollës.

3-Marrja pjesë në gjitha ftesat e shoqatave analoge dhe zgjerimi i veprimtarive në hapësirat shqiptare, por dhe ne që duhet të ftojme, për të bashkëpunuar, sipas rastit, seksioni i veprimtarive.

4-Veprimtari festive kushtuar 7-8 Marsit, në veçanti për nderimin e nxënësve të shkëlqyer në mësim të klasës së 9-të, të vitit të katërt të shkollës së mesme dhe studente dukagjinas të vitit fundit, seksioni i shkollës, gruas dhe veprimtarive të SHAD.

5-Promovime të botimeve të reja, sipas rastit ...Seksioni i librit;

6-Përfundimi e rivendosja e monumentit të ri albanologut Martin Camaj dhe rinaugurimi i tij, me rastin e 100 vjetorit të lindjes së tij, korrik 2025, Kryesia.

Në emër të SHAD, ju uroj Gëzuar festën e lindjes së Jezuesit dhe vitin e Ri-2025, një vit të mbare në jetën tuaj, në jetën familjare, në punë dhe kudo për të bërë jetën më të mirë, më të begatë!

Ndue Sanaj, Kryetari i SHAD

Gjuhadoli, rrugë në mes lagjes



LEONARD QYTEZA

Shkodra, kur mori formën e një qyteti të mirëfilltë, kishte katër hyrje kryesore: kah jugu prej Urës së Bahçallëkut; kah përendimi prej Urës së Bunës; kah veriu prej Urës së Maxharrit dhe kah lindja prej Urës së Kirit.

Herët, ajo kishte 31 lagje, shumë më tepër se ka sot. Emërtimet e lagjeve kanë veçoritë e veta, semantika dhe etimologjia e tyre bartin hamendësimet

dhe mëndyrat e veta të shpjegimeve, por përgjithësisht pranohen emrat e njerëzve themelues të tyre, përjashtim bën vetëm njëra nga këto, Gjuhadoli. Në shkrimet e veta, veterani i arsimit shqiptar, profesori dhe nëpunës në muzeumin dhe bibliotekën e Shkodrës, i ndrituri Gjush Sheldija, në të folmen shkodranishte shkruan “Gëjuhadoli”, jo thjeshtë si perdorim vetjak, por si dukuri e një ngjarje që vertetë ka ndodhur në ato mjedise të asaj lagjeje, dhe lidhet me “gjuhen” si mësim, si shkrim.

Por studiues të tjerë e lidhin emrin Gjuhadol me mikrotoponimin që vjen nga slavishtja “Gluho dol” - përroi i shurdhër.

Gjuhadoli në mesjetë njihej katund, kur qyteti ishte bri kështjellës “Rozafa”.

Të ndalem pak e të them pse po shkruaj?

Ashtë nevojë të shkruajmë sot në këto kohë, të kapim kohën e humbur në vitet e shkollimit tonë të detyruar, me lëndë të tepërta, që na morën shumë kohë e mundime, mësuam “dhunshëm” Historinë e PPSH, që nuk na hyri në punë kurrë, por vetëm për notën 10, po kështu edhe lëndët historike. Formimi ynë i thelluar në literaturën historike, të paktën me njohje vendin tonë, historinë e tij dhe të vendeve që na rrethojnë, kishte mangësi të theksuara, kishim të tjera prioritete në punë dhe në detyrat e përditshme. Mangësitë e trashëguara po vuajmë sot si shoqëri dhe

sforcot me kapë kohën e humbur, kanë kosto.

Literatura sot ashtë aq e mjaftueme sa na “fton” të lexojmë libra pas librash shkencor, historik dhe profesional, shtë edhe leximet në internet, me fjalë të tjera, bibliotekat personale janë shtuar, janë pasuruar, buxheti personal rritet çdo ditë, por vlen.

Ka do kohë që kemi në duar një libër me shumë vlera historike të një autori pak të njohur për brezin tim, i lindur me 1894 dhe jetoj deri në ditët e sotme pas vitit 1992, bëhet fjalë për Gjon Kamsi, i cili “ka pas një jetë dhe një veprimtari patriotice, që e kanë nda në shenj në gjysmën e parë të shekullit XX” dhe librin e tij, “Njerëz dhe ngjarje të lirisë së Shqipërisë”, Rradhonjtë e Shejzave, Botimet Shkodra, 450 faqe. Më duhet të them, pak libra kam lexuar nga ai autor, pak e kam njohur nga afër ndonse ishte një pinjoll i njëres nga familjet ma në zë të Shkodrës, në disa shekuj të kaluar. Ishte i ati i një tjetër personaliteti të naltë në Shkodër dhe në Shqipëri, një eruditi dhe diplomati, prof. Willy Kamsi.

Në lagjen Gjuhadol, me lagjen “Badra” e lagjen “Rusi i Vogël”, përfshi edhe “Serreqin”, gjetën strehim vëllaznuer atdhetarët shqiptar, nga çdo anë e vise t’ishin, siç përmenden në libër:

Aqif pashë Elbasani, MuKristo Fllaqi, Sejfi Vllamasi, Ilia e Kostaq Kota, Bedri Pejani, Mihajl Lehovala, Ahmet Dakli, Mil-

to Sotir Gurra, Fejzi bej Alizoti; gjetën të gjithë strehim familjar mikpritës për rreth rrugës Gjuhadol e nder të gjitha ato lagje, ajo e Gjuhadolit, e përfaqësuese nga rruga kryesore, me të njëtin emër, u bënë qendër drejtuese e mprojtjes së flamurit me shqype dykrenore, dhe me gurin e parë të një shtëpie si të moçmit na e kanë lënë në kujtim, si e pat vë nënkonsulli venedikas Anton Duada (cit. nga libri). Muço Qulli, Mehmet pashë Derhalla, Çerçiz Topulli, Bajram beg Curri, Sali Nivica, Sotir Peci, Bajram Fevziu,

Po, cilat ishin rrethanat dhe kushtet që Gjuhadolin e bënte qendër drejtuese e mbrojtjes së flamurit me shqipen dykrenore, shenj i shejtë i kombit për me mbajtë të ngrehun në këtë skaj të qytetit flamurin e të ngjallë ndjenjen e atdhetarisë e të lirisë ndaj të gjithë Shqipërisë së pushtueme nga armiqtë, të brendshëm e të jashtëm.

Siç ka ndodhur kudo në botë në mesjetë e më vonë, rreth një objekti kulti bashkohet edhe një popullsi dhe lind një bashkësi fillimisht e vogël, e pra, në rrethana të caktuara, në Gjuhadol aty rreth vitit 1870 filloj të marrë formë Kisha e Fretënvë dhe Kuvendi i tyre, moren formën që kanë sot, në vitin 1905, pasi pushteti i Stambollit nuk i jepte Ferman nga Sulltani për ndertimin e Kishës, kështu që, u desht ndërhyrja e Austro – Hungarisë që problemi të zgjidhej.



Kështu, filloj të ngjallej edhe jeta në këtë lagje, nga fretnit u krijua banda muzikore me Palok Kurtin, pat fillesat e para edhe shkolla për djem e vajza me pagesë nga dy gra mësuese, njihen si Kushë Micja dhe Tereze Berdica, e po kështu edhe Tina e Nikës, Gaspër Benusi me botimet e tija dhe të tjerë mësues, që shënojnë edhe mësimet e para të gjuhës së folur dhe shkrimt shqip.

Në vitin 1906, më i pari Guardjan i Kuvendit të Gjuhadorit kje P. Gjergj Fishta, i cili mbajti edhe Drejtorinë e Shkollës, mjafton emri i P. Gjergjit për me terheq vemendjen e të gjithë shqiptarëve kah Kuvendi i Gjuhadorit, nuk ka pas të huaj a të vendit me rëndësi shkencore a politike, që të ketë ardhë në Shkodër e të mos të kenë shkuar të takohen me fretën të këtij Kuvendi, në atë shkollë nisën e zhvilluen vepren arsimore edhe At' Shtjefen Gjeçovi, At' Vinçenc Prendushi, At' Justin Rrota e të tjerë mësues si Mati Logoreci e disa korifej të tjerë.

Në këto shpërthime të para të jetës françeskane dhe diturore u krijuan edhe arti teatror françeskan me vepra e para dramatike.

Shkodra, kjo "miter" nga ku u nis zhvillimi i herëshëm i kulturës sonë kombëtare, i artit të bukur të teatrit - posaçërisht - shënon në burime të ndryshme, se arti teatror fillon jeten e vet në Shkodër, me 24 Tetor 1880, me shfaqjen "Nata e Këshnellave" të françeskanit arbëresh Leonardo De Martino - dramaturg - realizuar nga nxanësit e shkollës françeskane dhe vepra të tjera të dramaturgjisë të daluna nga penda e artit dramatik të poetit P. Gjergj Fishta, ishte e para herë në historinë e qytetit që në një shfaqje shkollore, në teatrin e shkollës françeskane të vihet pjesa "GJUHA SHQYPE" (1911) dhe të jetë i pranishëm edhe Valiu i Stambollit e Komandanti i garnizonit turk në mbrojtjen e Shkodres nga rrethimi malezesh e serb, ai ushtaraku turk, Hasan Riza Pasha, që miqësinë me Pader Gjergjin e kishte të njëmendtë, si ushtaraku me një klerik të naltë dhe patriot të madh për çeshtjet shqiptare dhe kombëtare, miqësia e tyre është e njohur publike në atë kohë.

Jo larg me Kuvendin Françeskan, e sot, ne e dimë se vetëm "një hap larg" e pat shtëpinë edhe Kol Idromeno, artist, arkitekt, skenograf e sa e sa dije, i cili shkollën fillore që quhej "shkolla popullore", e ndoqi nga viti 1867 deri në vitin 1871, që mbahej nga kleri françeskan, dhe kur Idromeno u bë artist i madh, ishte Pader Gjergji, që i ofroj punë e projekte në kishat e ndryshme të Shkodres.

Fotografia zuni vend edhe këtu në Gjuhador, pikërisht në të hyrë të rrugës "Dedë Gjon Luli" e quajtur edhe e (Pistulloreve), në të djathtë të saj dikur kishte shtëpinë edhe Dom Ernesto Çoba - Monsinjori i fundit në 1967 - i biri i Luigjit. Arqipeshkëvi metropolitan i Shkodres kishte një vëlla e katër motra. "Motra Tone", emri i saj ishte Antonjeta, por shkurt thirrej Tone dhe ishte e motra e Kol Indromenos, ajo martohet me Andrea Skanjetin - plakun - , i cili ka qenë mësues i shkollës popullore françeskane dhe vajza e tyre, Orsolina martohet me Luigj Çoben, të atin e Monsinor Ernestit.

Pra, ajo shtëpi në hyrje të rrugës "Ded Gjon Luli", kishte një përbërje treshe Çoba

- Skanjeti - Idromeno, të gjithë që jetuan aty, emërmëdhënë. Në të tre dugajtë që pat ajo shtëpi, në katin e parë, Idromeno i përdori për ekspozim të fotografive dhe për shfaqje të filmave si kinema, sot ato dyqane janë pronë e zotit Mhill Shkami - një sipërmarrës ndërtimesh.

Në këtë rrugicë jetonte edhe mësuesi, arkivisti, ish nxanës i Kolegjës Saveriane, punonjës arkivist i Muzeut të Shkodres, botues i disa librave bazë për historikun e Shkodres, i ndrituri Gjush Sheldia. Po kështu, aty në atë rrugicë jetoj edhe Andrea Skanjet, nipi i Skanjetit plak, rregjisor i Teatrit "Migjeni" të Shkodrës, dikur punoi aty në Gjuhador për artin dramatik në Shoqnitë "Bogdani", "Rozafat", "Antoniane", por edhe "Vllaznia", vuni në skenë 22 drama, tragjedi, komedi, melodrama përfshirë edhe vënien në skenë të Operas "Mrika" të P. Jakovës.

Në rrugën e Gjuhadorit, siç thotë Gjon Kamsi në librin e tij që qe shtysa e shkrimt, "qesin kryet këto rrugë e rrugica, në djathtë dhe në majtë", sepse fill pas asaj "Dedë Gjon Luli" vjen rrugica e "Shën Kollit", në ballë të së cilës kishte shtëpinë patrioti Hilë Mosi, shkrimtar, publicist, kryetar i parë i Shoqnisë "Vllaznia", Ministër i Shkollimit i mbretit Zog, bashkëpunëtor i revistës "Albania" të Konicës, pjesmarrës me armë në dorë në Kryengritjen e Malësisë së Madhe në 1911, pjesmarrës në Kongresin e Lushnjes në 1920 e përfaqësues i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Pjesmarrja e Hilë Mosit në Kryengritjet e Malësisë së Madhe bëri që ai të ftoj Dedë Gjon Lulin të banonte për disa muaj pranë tij. Disi, përballë me rrugicën e "Shën Kollit" vjen rruga e "Gurazezëve", marrë emrin nga fisi i Gurazezëve, mendohet që të kenë ardhë nga Gjakova, por para se të vinin në qytet kanë qendruar në fshatin Guri i Zi. Në këtë rrugicë, përveç të tjerëve ka banuar edhe poeti Lllazar Siliqi, po ashtu edhe piktori i famshëm Zef Kolombi, filatelistë të ndigjuar, si Zef Prendushi i përmendur e me famë edhe në Europë në ekspozita ndërkombëtare, Mësuesi i Popullit Kolë Margjini, duhet përmendur se në këtë rrugë ka lindur edhe At' Pjetër Meshkalla, jezuiti atdhetar, guximtari i paepur në kohen e mbylljes së Seminarit të Jezuitëve nga rregjimi komunist, në hyrje të kësaj rruge del plot nur e hijeshi shtëpia - (projektuar nga Kol Idromeno, padyshim ndertesa më imponante në krye të rrugës) - e atdhetarit Ndoc Çoba, personalitet i shquar që në Kongresin e Lushnjes në 1920, si përfaqësues i Shkodres, Minister i Financave në qeverinë e Sulejman Delvinës e më vonë edhe kryetar i Bashkisë së Shkodres.

Pason në krahun e djathtë duke shkuar nga Serreqi, "Rruga e Darragjatëve".

Në rrugën e "Darragjatëve", e cila ka marrë këtë emër nga të parët qe e banuan, familja me të njëjtin emër, e vjetër, e njohur për tregëti e veprimtari të tjera dhe në miqësi me Luigj Gurakuqin. Në ballë të kësaj rruge, dera historike e shtypshkronjës "Fishta" e françeskanëve e themeluar në 1916, ku shtypej reviste "Hylli i Dritës", "Zani i Shna Ndout", gazeta opozitare "Ora e Maleve", "Posta e Shqipnisë" e shumë libra të tjerë. Deri në vitin 1916, shkrimtarët françeskanë i botonin veprat e tyre të Jezuitët apo edhe të

shtypshkronja e Dom Ndoc Nikaj.

Françeskanët e patën instaluar shtypshkronjën në një nga lokalet e shkollës fillore françeskane në mjediset e kuvendit të tyre, të Gjuhadorit. "Shtypshkronja funksionoi deri në vitin 1945, duke publikuar rreth 250 tituj librash e gazetash". (At' V. Demaj, Botime Françeskane - 100 vjetori i Shtypshkronjës Françeskane, 1919-2016).

Përballë me rrugicën e "Darragjatëve", ndodhet e bukur si dikur kur ishte e re, me ecejakët e saj, me ndërrimin e pronarëve në vite, aty kishte shtëpinë Filip Mazi, por edhe ka pas selinë e vet Shoqnia "Rozafat", por qe, dhe qendër e Klubit "Gjuha Shqipe", në vitin 1908, më vonë aty u vendos Shtypshkronja "Nikaj", pronë e Dom Ndoc Nikaj, shkrimtar, publicist, historian, romancieri i parë shqiptar, bashkëpunëtor me revistën "Albania" të Faik Konicës. Në Klubin "Gjuha Shqipe" bënin pjesë edhe Mati Logoreci, Kel Marubi e të tjerë patriot të rilindjes.

"Rruga e Gurakuqëve" quhej e tillë se aty ishte shtëpia atnore e Luigj Gurakuqit, nëmën të tij, "Kur Gurakuqi jetonte aty, shtëpia e madhe në Gjuhador qe kthyer në një vatër të gjallë atdhetarie e kulture. Rreth trevezës së saj mbledheshin intelektualët më të rëndësishëm të kohës, të cilët merrnin vendime, për veprimet që në vijim do të bëheshin për të mirën e Atdheut". (Konica.al).

"Më 1927 vdiq e ëma e Luigj Gurakuqit. Vetëm dy prifta dhe xhakontë e fretërve udhëhiqnin funeralin, kurse prapa vetëm pak vetë dhe një françeskan. Një kunorë me lule artificiale vendosur mbi arkivol e mbante mbishkrimin: "Nanës së dekur mas djalit të vramë". (Jakov Milaj "Kujtime për Shkodrën e viteve 1926-1931").

Në rrugën "Gurakuqi" pat banim të përherëshëm Bajram Curri, po ashtu aty banuan edhe Hasan Prishtina, Azem e Shota Galica në shtëpinë e Shan Koliqit, por meqenëse ajo rrugë kishte emrin e Luigjit, në kohën paranëntëdhjetës të shekullit të 20-të, rrugës së "Gurazezëve" ju vendos emni i Bajram Currit. Në kry të rrugicës "Gurakuqi", dikur ishte ndertesa e Ndoc Buflit, një shtëpi dykatëshe gjatë Luftës së Parë Botërore si dhe gjatë sundimit ndërkombëtar të Shkodres, ka qenë një lokal që asokohe quhej "Kafja e Madhe" e Frano Lleshit, që la mbrapa kafet e kohës së Turqisë, për atë modernizmin, si në qytetet e mëdha të Europës.

Lokali, në vitin 1919 qe qendra e Shoqnisë "Rozafat", një shoqëri artistike, teatrorë e muzikore, ku aktivizoheshin anëtarë me emën të spikatur si Zef Alimhilli, Gegë Marubi, Gjon Shllaku, Ernest Koliqi e të tjerë, me profesione të ndryshme, por edhe intelektual të tjerë të kohës si Zef Mark Harapi, At' Anton Xanoni, piktori Simon Rrota, piktori dhe arkitekti Kolë Idromeno, piktori tjetër i famshëm Ndoc Martini. "Kafja e Madhe" vlonte në atë kohë nga lëvizja e përditëshme e të gjithë atdhetarëve të krahinave të ndryshme, këtej e andej kufijëve kombëtarë, të cilët ishin strehu në Shkodër. U shifshin për rreth tryezave të Kafës së Madhe: Dedë GjonLuli, me Bajram Curri; Aqif pashë Elbasani, me Luigj Gurakuqin e Ahmet Daklin; Mehmet pashë Derhalla, me Bedri Pejanin; Bajram

Fevziu me Sejfi Vllamasin, Sotir Peci me Kristo Fllloqin, Ilia e Kostaq Kotta; Mati Logoreci me Ndue Palucen, Gasper Mikeli, me Gasper Beltojen e Luigj Naraçin; Mihajl Lehoval, me Terenc Toçin e Milto Sotir Gurren; Muço Qulli, me Çerçiz Topullin e Sali Nivicën; Filip Kraja me Palok Kurtin e Filip Pistullin, të cilët me Luigj Gurakuqin në krye, bajshin pjesë, nga ana katolikëve, në Këshillin Qeveritar të Qytetit, përkrah Këshillit Ndërkombëtar të Konsujve të Fuqive të Mëdha. (Gj. Kamsi)

Përballë me rrugicën e "Gurakuqëve", shfaqet Rruga e "Shna Ndout" apo e "Fretënve", dikur njëhej edhe si "Ndre Mjeda" e tash përsëri ndroroj emër në, e "At Gjergj Fishta".

Edhe në këtë rrugë historike, në kthesën e saj, dikur në shtëpinë e Tefë Prelës pat banuar familja e Injac Zamputtit - historian i mesjetës, shkrimtar dhe ish student i Kolegjës Saveriane të Jezuitëve si dhe profesor i atij institucioni ndër më elitaret që pat ndonjëherë vendi ynë në të gjitha kohrat.

Në këtë rrugë, përgjatë saj shtrihet Provinca Françeskane me Kuvendin e saj, Bibliotekën, Muzeun, Saloni i Shkollës Françeskane me 300 vende dhe me "kunorën" e saj Kishën e Gjuhadorit të Fretënve. Ato u vendosen në Shkodër në fillim, me 1875, e hap pas hapi filluan të shtrihen, krijuan në fillim Shkollën Popullore Françeskane në 1861 me leje të Sulltanit, duke qenë në këtë rast ndërmjetëse qeveria austriake. Në vitin 1902 At' Fishta qe drejtori i parë i asaj shkolle. që futi në pragmet mësimore gjuhen shqipe.

Pason në krahun e Gurakuqëve, "Rruga e Murgeshave Stigmatine", mori këtë emër sepse në vitin 1879 aty u themelua Kuvendi i këtyre motrave, katër të tilla të Urdhërit të Përgjithshëm Françeskan, të cilat morën për banesë rezidencë ku patën banuar françeskanët qysh në vitin 1861 (shtëpia e koprracës - quhej, një grua pasanike që nuk la trashëgimi), fillimisht Motrat Stigmatine janë marrë me vepra mëshiret dhe, më pas, duke hapur dyert e Shkollës së Murgeshave Stigmatine, 18 vite pas hapjes së Shkollës popullore Françeskane me drejtor të parë P. Gjergj Fishtën.

Edhe këtu motrat stigmatine, të parët e urdhërit të tyre, ndertuan Salonin e Shkollës Stigmatine me 250 vende, i cili, është edhe sot, poaq i bukur si dikur, madje edhe pas shkatërrimit të kishave, prishësit, nuk e "përdhosen", por e shëndrruan në "Klubin e Rinisë".

Rruga që mbyllë Gjuhadorin konvencionalisht, është "Rruga e Daullës", që tash në kohët tona quhet "Berdicej", sepse aty dikur ka qenë shkolla e Tereze Berdicës, ku ajo qysh në vitin 1921 ka qenë mësuese, që edukoi vajzat shkodrane në një shkollë private në formën e një klase kolektive me një mësues. Shoqe e ngushtë me Terezën ishte edhe mësuesja tjetër Kushe Micja, e cila ishte mësuesja e parë në Shkodër qysh në vitin 1859. Deri vonë, në fillim të rrugës së "Daullës" (Berdicej sot), në të majtë kur hyn, ishte ndertesa, kur dikur ishte shkolla e Tereze Berdicës, sot ajo është shndërruar në pallat banimi. Në këtë rrugicë ka pasë qendren e saj Orkestra Frymore e drejtuar prej Frano Ndojës, ajo qendroj aty deri në vitin 1923

e mandej, me bërthamen e saj të instrumentistëve, u krijua banda e Bashkisë së Shkodrës. Prandaj, ajo rrugicë mori emnin "Ruga e Daulles".

Në Gjuhador, krahas dy Shtypshkronjave që përmenda më sipër, në kohë të ndryshme, funksionuan edhe disa shtypshkronja të tjera private si ajo e redaksisë së gazetës "Republika", me një makineri të vogël, me drejtor të gazetës Kolë Ivanaj pronar dhe bashkëpunëtor i vëllai i tij, ish ministri i Shkolimit i mbretit Zog, Mirash Ivanaj, adresa e tyre ishte : Fletorja "Republika" – rruga Justin Godart – Scutari, Albanie. Po ashtu, në kohën e qeverimit ndërkom-bëtar të Shkodrës, u "ngreh" po në Gjuhador, një shtypshkronjë tjetër, dhuratë e princit Fuad, nip i Mehmet Aliut të Misirit, i fisit shqiptar, nga Kavalla e Rumelisë, kandidat për fronin mbretnor të Shqipërisë (Gj. Kamsi).

Në atë shtypshkronjë u shtyp fletorja e përjavshme e më vonë e përditëshme, e para në Shqipni, "Taraboshi", nën drejtimin e Adv. Terenc Tocci-it, arbëresh i Italisë. (po aty) Deviza e saj, në ballinë të gazetës ishte: "Thehem por s'perkulëm", Vietë I, Shkodër, e prëne 19 t'shtatorit 1913.

"Këtij shtypi shkodran e gjuhadoras, me ndëje në këtë rrugë Gjuhadori, e cila shquhej si qendër revolucionare të kombëtarëve shqiptarë ... ju shtuen, gjithnji të shtypuna në shtypshkrojet aty, fletore tjera, të cilat shpërngulen veprimtarinë e tyre, nga Vlonë e Durrësi, për në këtë skaj të Shkodrës, qi kishte mbetë Shqipnisë së lirë. E kjenë:

- E përkohshmjia "Atdheu", qi delte në Durrës nën drejtimin e Av. Mihajl Lehova.

- Fletorja "Populli", e drejtue me nga Muço Qulli, me redaktor Salih Nivicën, që delte në Vlonë, të cilën e braktisen për në Shkodër. - E Muço Qulli me Salih Nivicën, që nisën të botojnë në Shkodër edhe të përkoshmen "Drita e Popullit", (Gj. Kamsi).

Mozaik gjuhadoras, ngjarje dhe data:

1-Justin Godart, 31 mars 1921, e ejte. Pas dreke erdhën të më shohin Eprori i Françeskanëve dhe At' Gjergj Fishta. "Homeri i Shqipërisë", At' Gjergj Fishta, është madhështor në forcë dhe inteligjencë ... Nuk ka pikë dyshimi se në Shkodër ka një jetë bashkiake tepër të gjallë dhe të orjentuara kryekëput drejt përparimit. 2- Prill 1921, e premtë. Zhvillova një bisedë me Ministrin e mëparshëm të Arsimit, Luigj Gurakuqi. Mandej u nisëm për të ngrënë darkën në Bashkinë e qytetit. Aty ishin dy orkestra, fanfara dhe filarmonia e Vllaznisë.

3- Prill, e shtunë. Së fundmi vajtëm të takojmë At' Gjergj Fishta dhe të shohim kuvendin e tij. Kur u kthyem nga vizita tek At' Fishta vajtëm të rrëmojmë në dyqanin e rrobaqepsisë që ka gjëra antike, në rrugën aty pranë ... Bleva një kuti duhani dhe disa butona këmishe. Pastaj vajtëm të shohim bibliotekën e Kadiut. Ka mbi 500 dorëshkrime arabe, persiane, turke, disa prej të cilave të zbkuruara hijshëm....

Ndërkohë në shtëpi po më priste At' Gjergj Fishta.

Me At' Fishtën bëmë një bisedë të gjatë dhe të dobishme.

At' Gjergj Fishta dëshiron që Akademia Franceze të marrë drejtimin e kulturës

shqiptare dhe të kërkimeve historike që duhen bërë. Kur i thashë se mund të vijë një kongregacion fetar francez për të hapur shkolla, ai ma kundërshtoi mendimin dhe pranoi që ne të merremi këtu vetëm me arsimin e lartë dhe atë teknik. At' Gjergj Fishta mendon se shkollat fillore dhe gjimnazi duhet të jenë vetëm shqiptare.

(Justin Godart, "Ditarët shqiptarë" – mars 1921 – dhjetor 1951).

4. Fletorja "Taraboshi" e përditëshme, Dreituër: Adv. Terenc Toçi, Kryeshkrojsë: Spiro Kacaros.

Nji Leter e DED GJON LULI-T

Ded Gjo Luli, plaku luftaar, t'cillit mbasi luftoi t'tanë jeten e vet per Atme, ja dashtë me ulë kryet para t'paa rrugës diplomatike e ja dashtë me lanë edhe vëndin ku leu, i cili na shkruen ket leter: Shkoder 7-IX-914

Mik i dashtun

Une jam n'mëndim t'fletoret "Taraboshi" d.m.th. na nuk do t'perzihena n'mierimin europian, por do t'rriim gaadi. Na nuk do t'ngucim kerkënd, por me keë se ndokush po na bien, na do t'mburohena deri maa t'mramen pikë t'gjakut.

E mbassi mierisht, na nuk jemi t'rrregulluem, e mundet me ndollë, sikur tjera herë, si nji bairak asht i lánun vetun per mungesë t'bashkimit, pse endë duhet qi lidhja, mohamedan me t'kshtënë mos t'jeen vetun me fjalë, une po i lutem t'tanë vllazneve mohamedan, e mandei t'kshtënvë, qi t'm'keen mue e burrrat e mii gaadi per ta, n'kioftë se kan nevojë m'u mburue.

Kuitimeve e lutës qi une po j'u báj nepër miet t'fletores uej, i bashkohen me gjith zëmer edhe miqt e mii t'dashtun Ded Gjoni e Dok Uika bashkë me burrrat e tyne.

J'u falet ndeers, per t'pritunit zemberbardhë qi keni per t'i baa ksaj leter e j'u dergon shum shndet, me gjith zëmer, miku i juei fort i dashtun

DED GJON LULI

5. Albanologu austriak, Maximilian Lambertz i shkruan një letër nga Viena me, 20 shkurt 1921, P. Gjergj Fishtës ku ndër të tjera i thotë se, "...jam tash disa kohë tui punue e tui shkruen në nji histori të letratyrës Shqype, ... e për mos me lánë në anë kërkend autor e kurrjgá, shka asht shkruen Shqyp kah lamja e letratyrës, une e kam dishirin, me ardhë në ket prendverë në Shqypni, sepse aty une kam me mujtë má lehtas me i gjetë të tãnë librat, me i kerkue edhe gazetate e vjetra e të tjera.

E tash une vij me nji pyetje e me nji lutje te Zotnija Jote. A ka në Shqipni nji punë ose nji zyre për mue, për me punue aty e për me fitue aty buken?". (AT' GJERGJ FISHTA, OFM. LETËRSHKËMBIMI, fq.228). Mund të kuptohet lehtë se Lambertz e kishte fjalën për në Gjuhador, afër Fishtës se, pat thënë për Gjuhadorin, asht "Nji kopsht me lule e oaze culture".

Në vend të Epilogut.

Pra, Gjuhadori "Nji kopsht me lule e oaze culture"!

A gjendët kundtjetër një vend, një lagje apo një rrugë që të mbajë brenda saj ato "lule" dhe "oaze"? Jo, askund. Një rrugë kund treqind metra e gjatë, e drejtë dhe me rrugicat e saja si brinjët e një trupi, me shtëpi e dyqane poshtë tyre, me kopshte e bahçe mbushur me lule e pemë frutore, me puse uji të ftohtë e tan-

dat e rrushit, që rakis të mos mungojë për miq e për të lavdëruar Zotin, e bëri Gjuhadorin një emër famëmadh të historisë së Shkodrës dhe të Shqipërisë.

Aty, herët në 1875 filloj dhe u ngritë Kisha e Fretënve dhe Kuvendi i tyre ku shpejt zuri vend "frati, ky ah degagjanë mrizi" ardhur nga "kodërelterë të alpeve tona", siç thotë P. Daniel Gjeçaj, duke rrezuar dhe ndikuar me kulturen dhe dijet e tyre marrë në universitetet e Europës, në teologji, shkencë dhe arte në mbi 800 vite shkollim të gjithë së bashku, por me devizën e tyre për "Fe e Atme".

Një "bërthamë" tjetër rreth së cilit u frymëzuan, u përbashkuan, u këshilluan qe edhe Luigj Gurakuqi, emri i të cilit sot qendron në Panteonin e lufrave për liri dhe pavarësi, për kulturë dhe arsim kombëtar. Këto dy "pole" si institucione që mbartnin të gjitha vlerat më të mira të kombit shqiptar, në këtë rrugë të Gjuhadorit, bënë të bashkohen rreth tyre e gjithë bashkësia e atyre që populluan, që ndertuan, që shkrinë të gjitha energjitë, të dijes, të artit, të zhvillimit ekonomik e shoqëror që e bënë atë lagje e rrugë, qendren e gjithë asaj që lulëzoj aty, që luftoj aty, që shndriti përgjatë fillimshekullit të 20-të.

Gjuhadori kishte përgjatë jetës së tij:

1-Dy Kuvende, atë të Fretënve dhe të Motrave Stigmatine.

2-Dy Shtypshkronja, të "Fishtës" dhe të "Nikaj".

3-Dy banda muzikore, të fretënve drejtuar nga Palok Kurti dhe të arqipeshkëvisë e më vonë, e Bashkisë, drejtuar nga Frano Ndoja.

4-Dy Sallone teatrore, të Fretënve, me 300 vende dhe të Stigmatinëve, me 250 vende.

Në Gjuhador, lindën dhe u rritën e, më vonë shërbyen si Ministra të Arsimit:

1-Luigj Gurakuqi,

2-Hil Mosi,

3-Mirash Ivanaj,

4-Ernest Koliqi,

5-Ndoc Çoba (Ministër i Financave).

Në Gjuhador, lindën, por edhe u rritën piktorë me famë kombëtare si:

1-Kol Indromeno,

2-Zef Kolombi,

3-Simon Rrota,

4-Ndoc Martini.

Në Gjuhador, lindën dhe morën rrugën në jetë, këto "Mësues të Popullit":

1-Luigj Gurakuqi,

2-Mati Logoreci,

3-Kolë Margjini.

Në Gjuhador, u krijuan këto Shoqëri dhe Klube artistike, teatrore, muzikore dhe gjuhësore:

1-Shoqnia "Rozafat",

2-Klubi "Gjuha shqipe",

3-Shoqnia "Bashkimi",

4-Shoqnia "Antonjane",

5-Shoqnia "Bijate e Zojës",

6-Shoqnia "Vllaznija".

Ana tregtare dhe zanateve e Gjuhadorit:

E gjithë jeta njerzore, patriotike, kulturore, artistike e kësaj lagje e rrugë, kishte natyrisht edhe anën ekonomike dhe të aktivitetit profesional me zanatçinj të zot që bënë emër në mbarë qytetin. Tregëtar të shquar të kohës si: Shan Guraziu, Pjetër Darragjati, Pjetër Koliqi, Shan Koliqi, Ndreç Çoba, Tef Prela, Gasper Daberdaku e të tjerë.

Gjuhadori kishte Kafë e Pijetore me "namë" se punëtorja e lodhur nga punët e shumta në Pazarin e Vjetër të Shkodrës, gjithë stresin e ditës duhet ta kalonte për një kohë edhe sëbashku. Në Gjuhador numëroheshin 77 njësi tregtare e zanatesh të ndryshme, kafe e pijetore, gjithsejt 26 kanë qenë në rrugen kryesore.

Sa paguente i gjithë qyteti taksa në shitje të mallrave e të tjera, aq shlyente kjo zonë. Jo pak të zhvilluar e pat Gjuhadori edhe jetën sportive, në sajë të prezencës së shoqërive kulturore e sportive, të mirëqenjes ekonomike dhe të nevojës që Shkodra të jetë një qytet evropian siç protagonistët qytetar të asaj lagje, vërenin kudo nëpër Evropën e kohës.

Gjuhadori në vitin 2024.

Ka kohë që Gjuhadori ka marrë "statusin" e një rruge shetitore, me fasadat e shtëpive të vjetra të rregulluara sipas disa kritereve arkitektonike të një ansambli të trashëgimisë kulturore, por edhe koha ka punuar në vjetrimin e disa shtëpive dhe fasadave të tyre që po shkojnë drejt degradimit deri sa të presin ndërhyrjen e domosdoshme që të vitalizohen.

Edhe kësajsoj, bizneset e rrugës kanë gjetë forma të arredimit urban, me murale dhe gjetje artistike të kohës së internetit, që terheqja e të huajve që vizitojnë lagjen apo dëfrehen deri vonë në lokalet e natës me muzikë moderne e, jazz dhe rock&roll, ti josh edhe më shumë, madje ti japin jehonë Gjuhadorit te miqt e tyre aty ku kthehen.

Sot, në Gjuhador ka 56 njësi tregtare e sherbimesh (Tetor 2024).

Fjalët e fundit.

A mund të vijë një kohë tjetër, që Gjuhadori të bëhet përsëri qendër e kulturës, e patriotizmit, e shoqërive tregëtare, e shkëlqimit të dikurshëm në raport me jetën e sotme që ndryshon saora, drejt konsumizmit dhe jetës mondane?

Vështirë, Gjuhadorin e Shkodrës do ta "mbysë" intiligjenca artificiale përkundërt inteligjencës së viteve të '30-ta të shekullit të kaluar.

Vështirë, të vijë një Luigj Gurakuq, më!!!

FUND

Libra të shfletuar për shkrimin:

1-Gjon Kamsi "Njerëz dhe ngjarje të lirisë së Shqipërisë", "Radhënjtë e Shëjzave" – "Botimet Shkodra";

2-Gjush Sheldija "Historiku i Karnivaleve të Shkodrës dhe disa shkrime të tjera", "Botimet Shkodra"- 2020;

3-Guljem Pistulli "Gjuhadori"- Pjesë e randsishme e qytetit të Shkodrës;

4-Justin Godart "Ditarët shqiptarë" – mars 1921 – dhjetor 1951;

5-100-Vjetori i Shtypshkronjës Françeskane (1916 -2016) - Botime Françeskane.;

6-Jakov Milaj "Kujtime për Shkodrën e viteve 1926-1931";

7-Kolë Shtjefni "Shkodra", në shënimet e mija. "Bot Impex – 1997".

**Shkodër me,
28 Tetor 2024.**

NJË VIT PA LULASH NIKËN, BURRIN E GIMAJVE, DERË E HAPUR DHE SOFER E SHTRUME PËR GJYSËM SHEKULLI NË QYTETIN E SHKODRËS

Duhen shumë numra për të listuar burrat me kontribut të Gimajve, duke filluar me Vatë Lekë Gjokën i cili me aktin e tij heroik pat nderuar gjithë malësinë dhe Shkodrën, për të vazhduar me lufrat shekullore kundër pushtuesve dhe me përfaqësimin e trojeve tona në Kancelaritë Europiane dhe në takimet me Papën dhe Franc Jozefin në vitin 1917, nga burrat e Gimajve. Duhet veçuar në vazhdimësi një plejadë me personalitete të spikatur të artit dhe në veçanti të sportit tonë të quajtur "Mbretër të Sportit Shqiptar", të njohur dhe përtej kufijve të kontinentit, si nënkampion bote, apo gjenral, përfaqësues i shqipërisë në NATO. Nuk ka asnjë fshat në trojet mbarë shqipëtare që të kenë gënezën apo të kenë lindur kaq shumë personalitete sa Gimajt. Me këto figura të spikatura dhe shumëçka tjetër lexuesi do të njihet nëpërmes një enciklopedie për Gimajt.

Nëse kjo listë vazhdon deri në ditët e sotme, pa dyshim për shumë veti e virtyte do të ketë një vend edhe për Lulash Nikën. Nuk bëhet fjalë për një personalitet të spikatur të ndonjë fushe, nuk zotëroi ndonjë akademi apo gradë shkencore. Nuk kishte shumë shkollë, por shumë mend, dije, intuitë e maturi të cilat i rritën vlerat gjatë gjithë jetës. Tek Lulashi ishin të gërshetuara virtytet dhe vlerat më të spikatura të trashëguara ndër breza nga mjedisi ku lindi dhe u rrit. Akademia e tij ishte shkolla e jetës, përshtatshmëria me njerëzit, ambientin dhe kohën. Kishte një fantazi dhe zgjuarsi të pa përsëritshme të një prototipi dukagjinasi.

Të gjithë jemi kalimtar në këtë botë, por jeta tokësore është egzistenca dhe qenia jonë, për atë çfarë bëjmë për vehten, familjen dhe shoqërinë në përgjithësi. Jeta nëpërmes sfidave të panumerta të maturon në shumë virtyte e cilësi duke formuar personalitetin, karakterin dhe identitetin njerëzor. Ka individë të spikatur në publik si shërbëtorë të cilët sjellin vlera në shërbim të shoqërisë. Këta janë misionarë të vërtetë në komunitetin dhe në shoqërinë ku jetojnë duke ju shërbyer të tjerëve si individë me shumë vlera.

Lulashi ishte edhe përdorues i mirë i veglave muzikore tradicionale të malësisë sidomos në rininë e tij. Tingujt e tyre dëgjoheshin si në amfiteatër në lëndinat e bjeshkëve të Bobnajt, Njemzës, Pepçit dhe Moshekut, aty rrëzë Bigës legjendare.

Lulash Nika lindi në Radojë të Gimajve me datë 25.11.1939, një lagje e njohur nga e cila kanë lindur apo kanë gënezën figura të shquara përtej trojeve tona, në shtatmalin e Bigës vendi i Orëve dhe Zanave ku Fishta i Madh ju këndonte tek kënga e 16-të në "Lahutën e Malësisë". Vlerat, bukuritë dhe legjendat e kësaj zone i përshkruan Rose Lein në librin e saj "Majat e Shalës". Monumentet natyrore të Shenjta të papërsëritshme, së bashku me kalanë mesjetare të Gjytetit dhe Pusin e Kolë Gjonit të Kapresë së Gimajve i quajtur "Syri i Kaltër", Kryqi natyral i Gurit (me përmasa 4x3 meter), Gjurma e Shenjtë, si dhe Lejthia e Koçekut të Tisit (me diametër 103 cm) e papërsëritshme në rruzullin tokësor, këto janë pamje të veçanta të alpeve tona.

Në vitin e largët 1908 pranë oxhakut të

shtëpisë së Sokol dhe Nikë Marashit (gjyshi i Lulashit), Edith Durham shkruante fletët e ditarit të saj. Teksa ditët i kalonte duke ndihmuar edhe gratë e shtëpisë, Prenë Deden, Linë Ramjen e Pulë Miren (gjyshja e Lulashit). Për tu kthyer përsëri në këtë votër pas dy vitesh.

Plot 85 vjet më parë në këtë shtëpi do të shtohet edhe një djalë, i pagëzuar me emrin Lulash. Është djali i parë i Gjeloshit dhe i Ages së Mhill Nikës të Nicaeve, dikur derë e parë e Shoshit.

Vëllai i Ages, Dedë Mhilli ishte probatin dhe njeriu më i besuar i Ernest Koliqit, si dhe vëlla gishtit i Hysni Currit. Paraqitjen fizike të Dedës, fotografi i njohur Shan Pici në mbishkrimet e fotove të tij e quante "Kreshniku i Maleve". Mund ta quajmë një postulat të veçantë vlerësimin që i bënte Deda lindjes së një djalit: "Në qoftë se djali bëhet i mirë e i urtë i'a sheh hajrin katundi. Në qoftë se bëhet trim e i meçëm i prinë djelminisë. Në qoftë se bëhet budall, nuk din me u ruajt e vritet për gjak". Pra gjithsesi, ai argumenton rëndësinë e të lindurit djalë. Nga kjo derë Agia ishte më e vogla nga 4 motrat, padyshim më në zë në gjithë Dukagjinin. Nga dera e saj kishte mbartur çdo cilësi e virtyt që e shoqëruan gjithë jetën.

Familja e tyre u largua nga Gimajt duke u vendosur në qytetin e Shkodrës në fillimvitet 70'. Leja e banimit për një familje të zbritur në qytet ishte thujse e pamundur. Kjo vështirësi komplikohet edhe për faktin se në vitin 1952 ishte shpallur familje kulakësh me arsyetimin më absurd sepse kishte gjendjen e mirë ekonomike. Krahas sekuestrimit të pasurisë i vihët edhe taksim i veçantë. Në këto rrethana Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Qytetit Shkodër me datë 11.06.1976 shpall vendimin "Dëbim nga Qyteti", duke ju shtetëzuar edhe shtëpinë.

Më vonë falë punës së lavdërueshme shumëvjeçare të Lulashit dhe vllait Ndokës, në veprat e hidroenergetikës mbi kaskadën e Drinit, në brigdën e veçuar si "Brigada e Dukagjinit". Janë ndër të parët që përfitojnë shtëpi në lagjen Rus. Lulashi që në vegjëli përveç tre virtyte kryesore që lartësojnë burrin, malësorin e shqipëtarin: fenë, familjen e atdheun. Ai fali shumë dashuri për njerëzit dhe komunitetin ku jetoi dhe punoi. Një person i veçantë që nderoi vendin nga vinte duke plotësuar vijimësinë e burrave fisnikë me emrin dhe vlerat e veçanta. Lulashi u burrërua para kohe sepse në moshën 15-vjeçare i filloi kalvari i vuajtjeve të gjata, por duke ju përballur si askush tjetër.

Për shkak të përbërjes politike, ushtrinë e kreu në divizionin e punës në Lushnje. Falë strukturës fizike dhe punës me përkushtim nderon vehten dhe divizionin. Ndue Lulash Sokoli nga Pepsuj i Shoshit në vitet 1960-1962 tregonte për shokun e tij ushtar - se gëzonte një rrespekt të veçantë tek i cili spikatë humori dhe përdorimi i veglave muzikore, por më e veçanta ishte forca e tij fizike. Ndoja tregon për te, - se bënte mundje me më të fortit duke vepruar vetëm me njëren dorë, por shtatullat e tij nuk përkuleshin.

Vlen të veçohet episodi i Markut, një 6-vjeçar në Gimaj. Ky nuk lejonte vendosjen e tavanit të shtëpisë, me pretendimin se mbulohet trau i Lulashit. Ishte trau më i madh i shtëpisë që ai e kishte transportuar i vetëm, ndërkohë që të tjerët i mbanin nga dy burra, nga Qafa e Boshit.



Një ngjarje që bani jehonë në Shkodër në vitin 1983. Duhet vendosur Shtatorja e Usharit në Varrezat e Dëshmorëve në Shkodër. Rruga për transportin e shtatores me automjet nuk kishte, pas dy ditëve me datë 5 Maj bëhej inagurimi, urdhëri ishte i prerë. Kjo detyrë ju besua, veteranit të luftës Nacional-Çlirimtare dhe drejtor i ndërmarrjes së Riparim-Shërbimeve, Shyqyri Rrjolli. Duhet vënë në veprim fantazia dhe forca fizike. Si njeriu i përshtatshëm ai zgjodhi Lulashin, realizimi i kësaj veprë i bënte nder gjithë qytetit. Gjatë gjithë natës me disa punëtorë ai zmonton dhe transporton shinat nga tuneli i Pazarit të Vjetër-Ajasëm, drejt Varrezave të Dëshmorëve.

Bën montimin e tyre mbi traversa të improvizuara në pjerrtësinë e relievit. Mbi to ndërton një platformë prej druri me dy boshte dhe katër guzhineta, duke improvizuar një vagon dhe me anë të një kavoje mbi një baraban. Me anë të forcës fizike bëhet transporti i shtatores dhe me shumë vështirësi vendoset mbi platformë me shumë sukses.

Në ceremoninë e inagurimit në ditën e dëshmorëve, Lulashi merr gjithçka nga rrespekti i përfaqësuesve shtetërorë dhe të mijëra pjesëmarrësve shkodranë. Një kronikë të posatshme RTSH-ja, ja kushtoi këtij eventit duke evidentuar punën e Lulashit, duke e quajtur me epitetin "Dragoi i Shalës".

Çdokush që e pyeste se nga je, ai ju përgjigjej me humoren e tij karakteristik: "Prej vendit më të mirë të botës", dhe kur

kureshtja shtohet ai përsëri po me humor, ju thoshte: "Prej Lugut të Shalës". Më pas ndërmarrja dhe rrethi shoqëror i "ndërruan" emrin në Lucë Shala. Shpesh herë në ditë të veçanta administrata e ndërmarrjes e ftonë vetëm për të bërë humor, me sasinë e kripës që ata deshironin.

Ishte një kohë tejet e vështirë e pakonceptueshme për brezin e sotëm, buka ishte me gramaturë dhe çdo gjë ishte në zgrip. Hallexhijtë që vinin në qytet për probeme të ndryshme, nuk kishin ku të fusnin kokën, në të shumtën e rasteve flenin përjashta. Kishte vetëm një hotel publik me pak dhoma ku një natë kushtonte sa dy ditë pune në kooperativë bujqësore.

Ndërkohë për shumëkënd kishte një strehë, kjo ishte shtëpia e Lulash Nikës në lagjen Rus në portën e hyrjes nga veriu në qytet. Në qoftë se në shumë familje në qytet për arsye të ndryshme, nuk gjeje qasje as për të futur kokën, tek të cilat nuk mishërohej shprehja, shtëpia e Zotit dhe e mikut me bukë, krypë e zemer, për familjen e Lulashit qëndronte gjithçka ndryshe. Përsona të sëmurdë dhe me probleme, udhëtarë, fukarej, ushtar, nxënës e student, në këtë shtëpi gjenin mbështetje dhe zgjidhje të shumë problemeve, nisur nga fakti se rrethi shoqëror i tyre ishte zgjeruar.

Lulashi njihej pothuajse me shumicën e familjeve shkodrane e më gjërë, duke krijuar shoqëri, miqësi e besueshmëri me përsona me integritet në qytetin tonë. Fjala e tij zinte vend dhe rrespektohej nga nëpunës në nivele të ndryshme të institucioneve.

Në mes të alternativës mik apo çiflig, - ai zgjidhte të parën.


Duhet theksuar fakti se dyndja në këtë derë, nga të njohur dhe të panjohur ishte sa shpeshherë nuk i përballonte hyrja e pallatit dhe pjestarët e familjes flinin tek komshinjtë. Padyshim ishte dera malësore më mikpritëse e bujare në qytetin tonë në shekullin e fundit, së bashku me atë të familjes Gjeta nga Shoshi në ekstremin tjetër të hyrjes së qytetit, në lagjen Ajasëm. Në këto dyer shkollin jo vetëm përsona me kahje të kundërta politike, pa kurrfarë paragjykimi, por edhe persona në hasmëri të cilët i prisnin në dhoma të veçuara për te evituar kontaktin.

Zemërgjërësia e nënës Age bënte që shumë shpesh djemt, Ndokën e Luigjin ti nxjirrte tek agjensia (sot dollari) nëse kishte ndonjë hallexhi që priste të zbardhte, sidomos në dimrin e acartë. Nëna Age-siç e thrrisnin gratë e lagjes ishte me tipare të spikatura nga e cila kërkonin këshilla të vlefshme shumë gra të lagjes, ndonëse shumë prej tyre të mirëshkolluara dhe me profesione të ndryshme.

Lulashi dhe Agia ishin kolonat e shtëpisë dhe me ndihmen e bashkëshortes së Lulashit, Lezes, e dalë nga një derë e fisëshme e Prek Martinut nga Abati i Shalës. Vazat e martuara Lula dhe Lena përcollën në familjet ku u martuan anët më pozitive të prindërve të tyre të shtëpisë së Nikë Marashit.

(vijon në fqen 13)

Funksioni dhe statusi dinamik i dy figura të përjetshme të shkollës: mësuesit dhe nxënësit



FRAN GJOKA

Shkolla nuk është normale, në se nuk ka të kristalizuar misionin, qëllimin, funksionin dhe natyrisht edhe statusin dinamik të dy figurave të përjetshme të saj: mësuesit dhe nxënësit.

Koha e re e lirisë dhe demokracisë e ka detyruar shkollën moderne, për t'i përmbysur këto role të determinuar, këto pozicione të "stratifikuar" të qëndrimit dhe vlerësimit interdogmatik, të marrëdhënies midis mësuesit dhe nxënësit. Është e sigurt që shkolla demokratike shqiptare është duke krijuar dhe konsoliduar një relacion të ri, interaktiv, në marrëdhëniet midis tyre. Kjo do të thotë se raporti i mëparshëm, që njëri flet dhe tjetri dëgjon ka ndryshuar radikalisht.

Despotizmi më i keq është paternalizmi

Në shkollën e sotme, marrëdhëniet midis mësuesit dhe nxënësit janë të tilla, që të dy kanë marrëdhënie që ndikojnë mbi njëri-tjetrin, dhe të dy bashkë mbi të tjerët (shoqërinë). Shkolla nuk është më institucion edukativ i mbyllur në guaskën e relacionit të fosilizuar, determinist të mësuesit me nxënësin. Ajo është institucion social i rëndësishëm, në të cilin kultivohen vlerat e shoqërisë dhe të individit. Nxënësi nuk është më njeriu i klasifikuar sipas metodës së vjetër pedagogjike, në rolin pasiv të dëgjuesit dhe të nxënësit. Ai nuk është njësi e thjeshtë statistikore dhe e amzës. Çdo nxënës është një qenie njerëzore me cilësi, botë shpirtërore dhe identitet specifik, që ka qëllimet dhe synimet e veta të personalizuar. Shkolla moderne nuk është më institucion që i ndërton marrëdhëniet e mësuesit me nxënësin mbi parime të vjetra të "paternalizmit mekanicist", sëmundje e vjetër nga e cila ende nuk është shëruar shkolla jonë. Pedantizmi i mësuesit, mbivlerësimi i rolit të tij dhe nënvlerësimi i personalitetit të nxënësit është njëri nga shkaqet, në mos kryesori që sjell konflikte pedagogjike në marrëdhëniet midis tij dhe nxënësit në shkollë. Personalisht, gjithnjë kam menduar se ka patur të drejtë Kanti i madh, ky filozof universal i iluminizmit kur thoshte se "despotizmi më i keq është paternalizmi".

Mësuesi dhe nxënësi nuk janë "rivalë", por partnerë që kanë një mision të përbashkët

Kur flasim për këtë raport pedagogjik delikat të natyrës bipolare, për këtë relacion dinamik, midis dy figurave qendrore dhe të vetme të edukimit në shkollë siç janë mësuesi

dhe nxënësi, duhet të mendojmë se nuk kemi përballë dy "qenie të zbrazura" apo "njerëz të kulluar". Mësuesi dhe nxënësi janë dy "entitete njerëzore", identitete sociale të ndryshme. Kjo do të thotë se ato janë dy figura që kanë mendimin e tyre për njëri-tjetrin, të kondicionuar natyrisht nga relacionet sociale të jetës së sotme në vendin tonë, në kontekstin e të cilës "bashkëjetojnë" mësuesi dhe nxënësi. Ata në kushtet e shkollës moderne nuk duhet të jenë "rivalë", por partnerë që kanë një mision të përbashkët. Në një farë mënyre ajo që po ndodh në shkollën e sotme, është fakti që këto marrëdhënie tentojnë drejt një partneriteti interaktiv, funksionues dhe të barabartë. Në çdo kuptim që ta shikojmë shkollën moderne, ajo është dhe do të jetë një institucion i madh, jo vetëm pedagogjik, por dhe i marrëdhënies të demokratizuar midis mësuesit dhe nxënësit. Shkolla është vatër e madhe e "demokracisë së vogël". Aty ndërtohen marrëdhënie midis dy subjekteve që e ndërtojnë hierarkinë e tyre, duke respektuar lirinë, identitetin dhe "rolet" e njëri-tjetrit. Demokratizimi i marrëdhënies mësues-nxënës, natyrisht nuk ka terren për anarki pedagogjike. Por as shkak për të trembur mësuesin që nuk komunikon demokratikisht, apo argument në favor të nxënësit "rebel". Në këtë kontekst, shkolla si çdo institucion tjetër social, ka parime ndërtimi dhe rregulla e rregullore funksionimi që garantojnë marrëdhënie të drejta, lirinë "pozitive" dhe "negative", për mësuesin dhe nxënësin. Kjo do të thotë që nxënësi dhe mësuesi janë të lirë të ndërtojnë marrëdhënie produktive, duke u nisur nga parimi demokratik dhe pedagogjik, sipas të cilit në shkollë "liria e nxënësit" mbaron aty ku fillon e "drejta e mësuesit", dhe anasjelltas, e drejta e mësuesit mbaron atje ku fillon liria dhe e drejta e nxënësit për të gjykuar, menduar dhe vepruar.

E drejta dhe liria e nxënësit, për të qenë figurë aktive në shkollë

Në tërë këtë hapësirë lirie, nuk ka arsye pse të kemi përplasje midis nxënësit dhe mësuesit. Këto relacione nuk ndërtohen me mentalitete dhe paranojat e pedagogjisë së vjetër autoritariste, që nuk respekton të drejtën dhe liritë e nxënësit për të qenë figurë aktive në shkollë. Koha kërkon që "hapësirat respektive" të mësuesit dhe nxënësit, për të luajtur rolet e tyre si mësues dhe nxënës, të jenë të qarta. Normalisht, liria pedagogjike dhe demokratizimi i marrëdhënies mësues-nxënës, nuk mund të realizohen duke ndërhyrë padrejtësisht në hapësirat e njëri-tjetrit, duke krijuar anarki dhe kofoni pedagogjike, marrëdhënie kaotike, të paqarta, që sjellin konflikt midis tyre. Këto situata jo arkaikë të vjetra pedagogjike, as me mentalitete paranojake reciproke, midis mësuesit dhe nxënësit. Mbase ka ardhur koha për të riparë këtë relacion, në të dy drejtimet kryesore të demokratizimit të shkollës dhe marrëdhënies mësues - nxënës. Kjo kërkon që nga njëra anë të ridimensionohet koncepti për "autoritetin e mësuesit", duke e forcuar dhe demokratizuar jo si "autoritet të jashtëm", që sjell autoritarizëm dhe konfliktualitet në marrëdhëniet me nxënësin. Por nga ana tjetër, nuk duhet asnjë lëshim në konceptin që liria e nxënësit në shkollë është

pozitive, që do të thotë që ai është i lirë të mësojë dhe edukohet duke ju respektuar prirjet, dëshira dhe personaliteti. Por ajo është edhe "liri negative", në kuptimin që sjellja e nxënësit është e detyruar të jetë e përputhur me rregullat, rregulloret, parimet pedagogjike të shkollës, si institucion social. Ndërkaq mësuesi është i detyruar që me mjeshtërinë, përvojën, aftësinë, fleksibilitetin pedagogjik, (jo me dogmatizëm) të krijojë kushtet normale dhe atë "situatë pedagogjike", në të cilën nxënësi të ketë mundësi të zgjedhë alternativa veprimi, kulturimi në përputhje me dëshirat, aftësitë dhe prirjet personale. Kjo liri pedagogjike, nuk ka pse të jetë e huaj për shkollën tonë moderne, në se mësuesi dhe nxënësi dinë të respektojnë njëri-tjetrin, duke luajtur secili rolin e vet. Me fjalë të tjera, ka ardhur koha që në shkollë të punojmë që, duke e demokratizuar atë dhe marrëdhëniet midis mësuesit dhe nxënësit nga njëra anë, po kaq seriozisht të mendojmë për një "rikonceptim të roleve" dhe statusit të secilit, si mjet për mbarëvajtjen e punës dhe procesit mësimor dhe edukativ. Çështja e njohjes dhe respektimit të statusit të mësuesit dhe nxënësit, ndikon në krijimin e një atmosfere të veprimit të "hierarkisë shkollë", e cila është e domosdoshme për një institucion të tillë, me mision social dhe pedagogjik siç është shkolla. Në se do të arrimë që në shkollë të kemi përfytyrime të drejta për statusin e mësuesit dhe nxënësit, duke respektuar të drejtat institucionale të secilit, atëherë kemi për të patur një atmosferë marrëdhënies të mirëkuptimit reciprok. Kjo është ajo që i duhet shkollës, për të patur efikasitet dhe efikasitet socio pedagogjik, rezultate të prekshme dhe gjurmë të thella të relacioneve shpirtërore midis mësuesit dhe nxënësit.

Punën e mësuesit nuk mund ta bëjë kushdo

Nuk ka pse të ngatërrojmë shkollën me koncepte të skajshme konservatore, arkaikë të pedagogjisë së vjetër e të re, që janë provuar se kanë qenë dhe janë kundër produktive, të panatyrshme për shkollën moderne shqiptare, në stadin e sotëm. As nxënësi, por as mësuesi nuk janë ata që kanë qenë dikur, as marrëdhëniet e tyre nuk ndërtohen mbi parime të vjetra që ngatërrojnë "stauzet reciproke", që dëmtojnë punën e shkollës. Shkolla nuk është as vend i "pavarësisë së nxënësit" nga mësuesi, por as fushë beteje për të treguar "unin" apo egocentrizmin pedagogjik të këtij të mësuesit. Natyrisht mësuesi është në një situatë të veçantë, sepse është i detyruar të komportojë sjelljen dhe "unin" e tij, me nxënësit e tij që janë në të njëjtën kohë "grup", "tërësi kolektive" që duhet njohur, punuar dhe respektuar jo vetëm si grup, por dhe individualisht. Natyra e profesionit dhe e marrëdhënies të tilla kontradiktore, të punës me "grupin" dhe "individin" në të njëjtën kohë, është ajo që e bën të vështirë, delikate, me përgjegjësi dhe të lodhshme punën e mësuesit në shkollë. Ndaj është aq shumë e respektuar puna e mësuesit të vërtetë, të cilën nuk mund ta bëjë kushdo. Ai është mjeshtër për të gjetur "masën", midis lirisë dhe disiplinës që duhet të respektojë nxënësi në shkollë. Kjo do të thotë që duhet me kujdes të shikojmë atë raport delikat të të

drejtave dhe lirisë të natyrshme që ka nxënësi (liria pozitive), me atë të drejtë që ka shkolla dhe mësuesi për nxënësin që të respektojë rregullat dhe parimet e ndërtimit dhe funksionimit të shkollës (liria negative). Midis këtyre "dy lirisë", midis mësuesit dhe nxënësit është ajo situatë që ndikon në përcaktimin e statusit të tyre, është pikërisht ajo gjendje që mundëson funksionimin ideal të marrëdhënies, pa cenuar dhe nëpërkëmbur të drejtat e njëri-tjetrit.

Shkolla ka misionin të edukojë qytetarë aktivë, humanë dhe me personalitet të pavarur

Shkolla është institucion dhe natyrisht që ka nevojë për "hierarki" vlerash dhe njerëzish, që kanë role të ndryshme bashkëpunuese. Konceptet e vjetra të shkollës hierarkike, janë shpesh shkak për konflikte dhe situata të pakëndshme, midis mësuesit dhe nxënësit. Në se do të duhej të gjeja një term, që mund të përcaktojë se si duhet të jenë në kohën tonë marrëdhëniet e mësuesit me nxënësin, unë do të preferoja që ato në esencë të jenë në pozicionin e "hierarkisë së harmonishme". Nuk mund të ndërtohet shkolla e re e demokratizuar me mësues që kanë në mendje ide dhe konceptet e shkollës së vjetër totalitariste që e shtypte lirinë e nxënësit. Tani është kohë tjetër dhe natyrshëm shkolla është e detyruar të mbajë "barrën e lirisë", të institucionit të lirë, që nuk ka për mision të edukojë nxënës të trysuar me parime të moralit dhe pedagogjisë së vjetër. Shkolla tani është një institucion që ka tjetër mision, të edukojë qytetarë aktivë, të guximshëm, humanë, antikonformistë, me personalitet të fuqishëm e të pavarur. Këto vlera dhe cilësi që duhet të kultivojë shkolla, nuk mund të realizohen me konceptin e vjetër të statusit të mësuesit si tutelë mbi nxënësin pasiv, timid, të flashkët, pa vetëdije personale. Shkolla është vendi i parë ku nxënësi kërkon të afirmojë personalitetin dhe identitetin e vet të dallueshëm. Kjo kërkesë dhe dëshirë e natyrshme e nxënësit, nuk ka pse të cenojë personalitetin e mësuesit të "lëkundur", i cili nga që mund të mos jetë i aftë të përballojë këtë kërkesë legjitime, trembet e kap paniku dhe nervozizmi pedagogjik. Dëshira e nxënësit për të afirmuar personalitetin, nuk cenon aspak, nuk e vë në krizë autoritetin e mësuesit të talentuar, që di të kuptojë këtë aspiratë të nxënësit, duke ndërthurur ndërkaq marrëdhënie të mira ndikuese me të. Nuk është e drejtë frika që kanë disa mësues, për "kufijtë" e cenuar të autoritetit të tyre. Sipas mendimit tim, pavarësisht proceseve demokratizuese që kanë përfshirë shkollën tonë, ka për të qenë kurdoherë e pranishme dhe e diskutueshme pyetja e mësuesit se "deri ku duhet të shtrihet autoriteti" i tij. Por ndërkaq edhe nxënësi ka po aq të drejtë të pyesë, se "deri ku janë kufijtë e lirisë" së tij. Kjo situatë dikotomike midis "autoritetit të mësuesit" dhe "lirisë së nxënësit", është dhe do të jetë problem i përjetshëm, ekzistencial i shkollës. Asnjëherë shkolla nuk është normale, në se nuk ka të kristalizuar misionin, qëllimin, funksionin dhe natyrisht edhe statusin dinamik të dy figurave të përjetshme të saj: mësuesit dhe nxënësit.

NDUE FTONI DHE KONTRIBUTET E PAÇMUESHME TË BAMIRËSISË

Për Shoshjanët është shkruar prej qindra vjetësh nga studiues, klerikë, historianë, gjeograf dhe vizitorë të huaj. Ndër vite kjo histori është pasqyruar nga studiues dhe shkrimtarë shoshjanë dhe më gjërë. Po të veçojmë burrat e spikatur të Shoshit në kohë dhe në fusha të ndryshme ndër mote do të ishte një mision i pamundur. Për çdo kalemxi sado të përgatitur do të ishte e vështirë, gjë për të cilën nuk do ta merrja përsipër. Të gjithë jemi dëshmitarë të historisë shumëshkëllore të Shoshit. Ky truall ka qenë burim i përhershëm i burrave të mençur, trima, mendimtarë, mbi të gjitha luftëtarë përballë pushtuesve në çdo moment të historisë. Unë si profesionist në fushën e mjeksisë prej katër dekadash e gjysmë dhe duke patur pasion letërsinë e ndjej vehten difiçitar në aspektin human, sepse duke publikuar figura të ndryshme ndër vite ndjej mangësi për vetë faktin se nuk kam evidentuar humanizmin e një burri nga Shoshi ndër dekada, prej kohësh i konfirmuar kudo ku jetojnë dhe punojnë shqiptarët. Ky rrjell nga një derë e fisshme, për të cilin i është kushtuar roman, poetët i kanë thurur poezi dhe këngëtarë të njohur i kanë kënduar këngë. Plot tre vjet më parë tek po thurja tekstin e një kënge për vëllezërit Lleshi "Gjithmonë Shoshi ka rrit burra", më vinte keq teksta nuk e përfshija edhe personazhin e shkrimit të sotëm. Arsyeja ishte se këngën ua kushtoja brezit të kaluar, të cilët nuk jetonin në bashtinën e sotme. Gjithsesi poetë e këngëtarë të ndryshëm e kanë plotësuar këtë mangësi timen me këngët që ia kushtuan kësaj figure.

Sapo u emërova në punë në Ndrejt të Shoshit në vitin e largët 1986 e dija se gjyshi im ishte nip nga një derë e fisshme e Ded Mhillit të Preçajve në Ndrejt. Një ndër pinjollët e kësaj kulle është edhe kryefjala e shkrimit tonë, Z.Ndue Ftoni.

Ruaj në memorien time një djalosh i ri me një paraqitje shumë simpatike, me shumë ëndrra dhe ambicie me vizion për jetën.

Afro tre dekada më parë Z.Ftoni, si shumë të tjerë mori rrugën e emigrimit drejt "Tokës së Premtuar" por me një veçori ndryshe. Ai largohet vetëm fizikisht përtej Atlantikut, pasi mendja dhe zemra i punonin për Ndrejt, Shoshin, Dukagjinin dhe gjithë Shqipërinë. Po ti shikojë një i ri sot të regjistruara imazhet vizive të dhimbshme të përcjelljes nga familjarët e të afërmit, në ditët e sotme atij vërtet do ti duken si imazhet e filmave të sajuar të tipit, "Përrallë nga e Kaluara". Ndërsa sot duke i krahasuar këto imazhe me arritjet e Z.Ndue Ftoni të kujtojnë një tjetër film, "Liza në Botën e Çudirave". Me rastin e aksidentit tragjik në rrugën e Kirit në vitin 2007 ku tragjedia i mori jetën 10 personave dhe la dy të plagosur, ishte Z.Ftoni që mbledhi rreth 11.000\$ bashkë me donatorë të tjerë. Mision i pamundur për mua është fakti i evidentimit të kontributeve të tij në Dukagjin e Shkodër por edhe më larg. Për vetë faktin që nuk kam

marrë konfirmimin e tij, prap se prap nuk mund të rri pa përmendur një rast unik të veprës humane të tij por duke i kërkuar ndjesë për publikimin e këtij akti.

Pesë vjet më parë tragjedia i merr jetën çiftit bashkëshortor Petrit e Dava nga Puka, ku mbeten jetim katër fëmijë minore dhe të plagosur, nga zjarri që përpiu gjithçka. Ishte humanizmi njerëzor i Z.Ftoni i cili me anonimatin e tij dhuroi mijërat e dollarëve për këta vogëlushë, ndërkohë që këtë informacion e kam të dhënë nga një tjetër dukagjinas shok i tij dhe mik i imi. Humanizmi dhe zemërbardhësia e tij bënë që të kontroibojë në shumta të konsiderueshme në ndërtimin e një xhamie në Kopluk. Po të citoj raste të tjera për të cilat kam informacion, lista do të ishte pa limit por më duket se do të zbehte disi dy rastet tipike të mësipërme. Vlen të përmenden përpjekjet ndër vite për sensibilizimin e organeve lokale dhe shtetërore duke lobuar me financimet e tij për rrugën e Dukagjinit, apo takimin e zgjeruar në "Restorant Blini" me përfaqësues nga e gjithë zona, tetë vjet më parë. Me këtë rast u krijua një shoqatë me një bord me individë të respektuar, por fatkeqsisht jo të nivelit për të lobuar me qeverinë, megjithatë përpjekjet e tij mbetën permanente në vijimësi. Ai vazhdoi lobimin në të gjitha instancat e pushtetit qën-



dor.

Z.Ndue Ftoni e filloi dhe e vazhdon rrugën e suksesit në biznes, duke qenë shumë aktiv në jetën shoqërore, dukagjinas dhe atdhetar aq këmbngulës për realizimin e veprave në dobi të komunitetit. Për të gjitha këto emri i tij mbetet i përvetshëm. Janë vlera njerëzore të manifestuara në jetën e tij të përditshme duke mishëruar pozitivitetet. Autorësinë e sponsorizimit të Z.Ftoni e mbajnë shumë donacione për vepra të ndryshme të kultit dhe infrastrukture, objekte të ndryshme, aktivitete social-kulturore dhe artistike, pritje dhe përcjellje jo vetëm të personaliteteve të ndryshme por edhe të atyre që kanë patur nevojë për bukën e gojës. Për të gjitha këto dhe shumë të tjera është vlerësuar nga autoritete e shtetit shqiptar. Z.Ndue

Ftoni me bizneset e tij të suksesshme ka punësuar shumë shqipëtarë dhe të huaj. Prej shumë vitesh ka qenë pronar i TV Shqiptar. Ai është vlerësuar dhe nderuar nga Ministria e Industrisë dhe Ushqimit në Michigan dhe në veçanti nga Kongresi dhe Autoritetet e këtij shteti për arritjet dhe bamirësitë e tij duke u bërë i njohur nga personalitete të ndryshme amerikane. "Shoqata Atdhetare Dukagjini" e vetmja në Shqipëri që mban gazetën e saj, me 21 vite jetë ka pasur mbështetjen e pakursyer të tij i cili ka sponsorizuar plot 43 numra të derisotëm që kapin një vlerë prej 956.000 lekë ose e thënë ndryshe ka sponsorizuar mbi 16% të numrave të saj. Gjithashtu ka kontribuar për ndërtim monumentesh, botim librash e veprimtari artistike të cilat kapin një vlerë mbi 5000\$. Me rastin e pandemisë ai i dhuroi 1000\$ Bashkisë Shkodër, si kontribut për familjet më në nevojë. Gjithashtu në vitin 2014 ka sponsorizuar rreth 4000\$ për ndërtimin e palestrës për sportin e mundjes.

Për çdo shqipëtar që ndjen vehten patriot brenda apo jashtë trojeve që ka ndjenjën e patriotizmit dhe të atdhedashurisë duhet që mbi pasionin partiak të triumfojë fryma atdhetare e shqiptarisë e trashëguar ndër shekuj. Gjithsecili sipas mundësisë dhe dëshirës duhet të kontribojë sadopak qofte edhe me një vlerë sim-

edhe individë që mendojnë krejt ndryshe, sipas logjikës së tyre meskine çdo person duhet të pëlqejë apo të simpatizojë atë parti, politikan apo personalitet që atij i pëlqen. Mirëpo edhe vetë barkushet e çdo zemre kanë ritmi të ndryshme.

Tek po shikoja nga ekрани rastësisht takimin e kryeministrit në New York në pjesën e fundit të bashkëbisedimit me bashkëatdhetarët, ku ai disa herë përmendi Thethin, Shkodrën e Veriun njëkohësisht që operatori herë pas here fokusonte Z.Ndue Ftoni, e kuptova se ky i fundit kishte bashkëbiseduar me kryeministrin dhe kjo më rezultoi e vërtetë. Mendoj se në veçanti çdo dukagjinas i çfarëdo formacioni, niveli apo paragjykimi duhet të ndihej krenar për këtë. Mirëpo e vërteta shpesh nuk është në krahun pozitiv. Shumë prej atyre që paraqesin simptoma të ndryshme kanë reaguar sipas mënyrës së diagnozës të sëmundjes së tyre kronike e cila nuk lejon të vetëshohet. Unë nuk marr përsipër avokatin e Z.Ftoni, por kam të drejtën e Zotit të them disa të vërteta. Disa persona fatmirësisht në miniaturë por me "aftësinë" e askushit japin këshilla e receta standarte për kedo që i del përpara nga afër apo nga larg, por gjithmonë duke mos shikuar vehten se çfarë janë, apo çfarë përfaqësojnë. Ka prej kësaj kategorie që janë shprehur se çfarë duhet ti kishte sugjeruar kryeministrit për mirëqeverisjen e Shqipërisë. Këto opinione vlejën vetëm në rastet ku pihet raki çylekut me turshi të ufulluara, të cilat stisin sistemin nervor qendror. Sipas kësaj logjike "filozofike" Z.Ftoni i bie që të jetë bashkëfajtor me kreun e shtetit për qeverisjen jo efçente të vendit. Kësaj specie ju duhet thënë "Fali o zot se kanë probleme me logjikën". Për këdo është nder të takojë drejtuesin e shtetit në emigracion, e veçanta e tij është se ka bashkëpunuar si shqipëtar me shqipëtarin dhe jo si shqipëtar me partiakun. Këto takime nuk kanë qenë thjesht për të realizuar fotografi, por pavarësisht krahit politik janë tregues i vlerave burrërore e atdhetare të manifestuara në këto vite emigrimi të suksesshëm të tij. I suksesshëm në jetë dhe në biznes, aktiv, krahinor dhe atdhetardashës. Kryeministrat e çdo vendit duhet të priten kudo nga emigrantët jo si partiakë, çdo këndvështrim tjetër edhe sikur të pranohet është i pakuptimtë. Z.Ftoni në vijimësi në ambientet e tij ose në takime të ndryshme në prezencë të personaliteteve të ndryshëm ka takuar: Liderat shqiptarë, Z.Berisha si kryeministër, Presidentët Bamir Topi dhe Bujar Nishani, Kryetarin e Partisë Demokratike Lulzim Basha, Ministrin për Diasporën Pandeli Majko, dhe kryeministrin Edi Rama. Ka takuar dhe pritur liderat kosovarë Hashim Thaci, Atifete Jahjaga, Bexhet Pacolli, Albin Kurti dhe shumë personalitete tjerë. Ndër personalitetet botërore ka takuar, Presidentin Amerikan Bill Clinton, Presidentin Britanik Tony Blair, Guvernatorët e New York-ut dhe Detroit-it, si dhe shumë

bolike ose në ndonjë spontan të veçantë.

Gjatë fushatës elektorale në teatrin Migjeni mua mu dha mundësi gjatë një shtrëngimi duarsh dhe një fotoje me Z.Rama ti drejtohem, duke i përsëritur retorikën e gjithë Dukagjinit "Duam Rrugën" une iu drejtova: "Z.Kryeministër shpejtoje ndërtimin e rrugës së Dukagjinit, sepse është rruga e të parëve të gjyshes tënde (duke pasur parasysh familjen Kolombi). Ai mu përgjigj me një gjestikulacion të lezetshëm duke shtrënguar dhëmbët e duke tundur kokën në shenjë pohimi". Drejtuesit shtetërorë zgjidhen nga populli, dhe në fund të fundit çdo popull meriton qeverisjen e vetëzgjedhur. Në vendet me demokraci të konsoliduar gjithsecili ka të drejtën e sanksionuar se cilës parti i takon të simpatizojë ose të zgjedhë. Ka

Senatörë e Kongresmen kryesisht të pranishëm në bizneset e tij. Në vitin 2014 ka fituar vendin e parë si lider biznesit me pjesëmarrjen e 500 biznesmenëve më të suksesshëm.

Me rastin e Vitit të Ri në 2013 në Detroit priti një shoqatë para dhe tetraplegjikësh prej 250 vetash gjë e cila bëri jehonë në mediat vizive dhe të shkruara në Detroitit dhe më gjërë. Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, Z.Ndue Ftoni priti 1200 Shqiptarë dhe Kongresmenë e Senatörë. Me këtë rast autoritete të ndryshme e kanë dekoruar në emër të Kongresit Amerikan dhe me certifikatë nga Kryetari i Shtetit Michigan. Z.Ndue Ftoni është një person i cili pavarësisht këtyre zërave që flasin..... ai është në krye të karvanit që shkon rrugës. Përsonazhi i këtij shkrimi nuk është përveçse një kontributor për trojet e veta, fatmirësisht numri i dukagjinave tonë në këtë rol është i konsiderueshëm. Është detyrë njerëzore dhe mirënjohje të flasësh për këta kontributorë të cilët jetojnë e punojnë përtej oqeanit, ku mendja, zemra dhe buxheti ju punon për vendlindjen. Shuma e donacioneve të tyre nuk ka të krahasuar me buxhetin e qeverisë vendore apo qëndrore, në harkun e 33 vjetve. Këta kanë kontribuar në infrastrukturë, objekte dhe me ndihma të ndryshme duke përfshirë edhe ato të epidemisë gjithsejt 160 subjekte, ndër to edhe fondacione të huaja të lobuara nga ana e tyre. Nga këto donacione kanë përfituar 600 familje në nevojë me banim në Dukagjin dhe në rrethinat e Shkodrës, si në medikamente, ushqime, veshmbathje dhe vlera monetare të drejtuara nga grupi nismëtar "Shaljanët në SHBA për trojet e

tyre" të drejtuara nga Z.Ded Prendaj i cili në vitin 2023 financoi edhe "Memorialin e Martirëve të Kishës".

Në vitin 2021 bashkësia e Dukagjinit në drejtimin e Z.Gjin Markaj krijoi një komision të posatshtëm ku përfshin edhe subjekte e donacione të huaja nga Amerika. U riparuan shtëpi, ujësjellsa, Kisha, buste, memoriale e vepra të tjera social kulturore bashkë me familjarët e tij. Në vitin 2022 përfundoi kisha e Gimajve financuar nga "Shoqata Bajraktari" në New York nga babë e bir Z.Vate e Ilir Biga dhe Gjovalin Biga. Ndërsa në 2024, përsëri Iliri djaloshi i Gimajve lindur dhe shkolluar në New York "solli" në Shqipëri Papa Klementin e XI. Një tjetër emigrant kontribues është edhe Thethjano-Amerikani Nush Noli. Një djal tjetër i Gimajve, Kujtim Funiçi me familjen e tij është kontribues financiar permanent në organizimin e përvitshëm të aktiviteteve të ndryshme kulturore. Përsëri emigrantë të tjerë nga Gimaj që kanë kontribuar janë Z.Tonin Mrapshtia e Z.Vladimir Lepaja. Një shoshjan tjetër kontribues është Z.Gjergj Temeli në financimin e objekteve shumë të rëndësishme. Gjithashtu zotëritë Ded Tonaj e Ndrek Tonaj. Do t'iu kërkoj ndjesë disa kontribuesve të cilët nuk i citova të cilët mund ta meritojnë, por fatmirësisht janë të shumtë dhe uroj që të shtohen edhe pse unë përsëri mund të harroj ndonjërin. Ka individë jo të pakët në numër të cilët në mënyra të ndryshme përpiqen të denigrojnë për të demotivuar këta kontributorë dhe jo vetëm, por edhe figura të intelektualëve të njohur si Dr.shkencash, profesorë, botues, publicist, poet, sponsor, drejtues shoqate

dhe gazete, këngëtarë, ka edhe intelektual që kanë vetëfinancuar krijimtarinë e tyre në shuma të konsiderueshme. Kjo kategori mediokre që pretendon për "madhësinë" e tyre si njohës të historisë dhe të çdo fushe, por fatkeqsisht janë gjysmë analfabetë të cilët në rastin më të mirë kanë harruar, atë pak shkrim dhe këndim. Komunikimi i tyre në rrjetet sociale duke përdorur anonimatin është i veçantë, duke përdorur terma dhe epitete jo vetëm që nuk dijnë kuptimin por edhe fjalë të cilat nuk gjenden në fjalorin e ndonje gjuhe. Këta bëjnë vërejtje mundohen të kapen pas cikërrimeve të parëndësishme duke hedhur baltë mbi këta kontributorë. Ka prej atyre të cilët mosmirënjohjen e shprehin edhe kundrejt njerëzve të tyre të cilët dikur janë përkujdesur për ta që në fëmijëri. Ky grup fatkeqsisht nuk është minorancë por vjen duke u shtuar, duke hedh baltë mbi këdo, përfshirë këtu edhe smirëxhitë të cilët shumë prej tyre kanë edhe buxhet, por nuk kanë ndjenjen më minimale të humanizmit njerëzor apo të bamirësisë, biles as për prindërit e tyre me pensione minimale në kufirin e mbi jetesës. Në kohët që po kalojmë shikojmë një shterrim të burimit të virtyteve siç janë ato të dashurisë, mirënjohjes, humanizmit dhe nacionalizmit. Ndoshta ngaqë fenomeni i kohës së internetit ndikon në këtë shterrim. Fatkeqsisht ky fenomen po bjen duke u zgjeruar, ku mosmirënjohja thuajse është institucionalizuar duke arritur në nivelin e papërgjegjshmërisë. Iolla këta shembuj thjeshtë për të inkurajuar edhe më tepër Z.Ndue Ftoni dhe shumë të tjerë sepse kushdo që mendon të bëjë punë të vlefshme për komunitetin,

më parë duhet të mendojë për reagimin e kësaj "specie" të veçantë. Një filozof francez ka thënë: "Kur flasin injorantët, inteligjenca duhet të heshtë". Gjithsesi këta individë të veçantë duhen mishëruar sepse nuk kuptojnë as vetëvehten. Në këto rrethana njerëzit zemërmirë duhet të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të mirën e komunitetit. Kjo duhet ti motivojë sepse gjejnë mbështetjen morale të të gjithëve duke vlerësuar kontributet e tyre. Për këto kontribute është vlerësuar edhe Z.Ndue Ftoni ndër të cilat po veçoj disa prej tyre:

Nderi i Qarkut të Shkodrës

Mirënjohja e qytetit të Shkodrës

Mirënjohja e Bashkisë Malësia e Madhe
Ambasada Botërore e Paqes për të Drejtat e Njeriut me qendër në Tiranë i ka dhënë çmimin "Ambasador i Paqes Botërore për të Drejtat e Njeriut", shqiptaro-amerikanit Z.Ndue Ftoni me banim në Michigan.

Nderi i Unionit të Artistëve të Kombit Shqiptarë

Nderi i Shoqatës Atdhetare Kulturore Mbarëkombëtare "BENDA"

Qytetar Nderi i Komunës Shosh

Qytetar Nderi i Komunës Rrethina

Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini

Të gjitha këto arritje ndër vite si pak kush në Shqipëri Z.Ftoni i ka arritur edhe në saje të mbështetjes së vazhdueshme nga familja e tij, bashkëshortja dhe fëmijët. Do të dëshiroja që Dukagjini, Shkodra dhe mbarë Shqipëria të kenë shumë bijë puntorë dhe zemerbardhë që të kontribojnë për vendin si Z.Ndue Ftoni.

MARK BOBNAJ,

mjek stomatolog dhe studiues.

Dhjetor2024

(vijon nga faqja 10)

Të flasësh për Ndokën, për bamirësinë, bujarinë dhe zemërgjërësinë duhet kohë e gjatë. Ai për 6 vjet kreu me ndershmëri detyrën e drejtuesit të Inspektoriatit të Persekutuarve Politik të Qarkut Shkoder nga vitet 2002 deri në 2008 duke ndihmuar dhe respektuar çdo person e në vecanti Dukagjinasi.

Motra e tyre e vogël Zoja e diplomuar në vitin 1984 si Inxhinjerja e parë e Tekstileve në Shkodër dhe drejtoreshë e Tisazhit, dhe për shumë vite si drejtuese e Zyrës së Punës pranë Bashkisë Shkodër. Ajo prej shumë kohësh së bashku me bashkëshortin e saj, ish-basketbollistin, mjeshtrin e njohur Lekë Sinishtja dhe fëmijët e tyre që jetojnë në Zvicerr dhe janë pronarë të një biznesi shumë të njohur ndërkombëtarisht.

Vëllai i vogël Luigji prej disa dekadash jeton me familjen e tij në Milano. Familja e Lulashit dhe e Lezes përbëhej nga dy fëmijë, Iliri i martuar me Majlindën me dy djemtë që jetojnë në Padova.

Për vajzën e tij Filen, e kam të vështirë të flas sespe në moshën e pjekurisë, një sëmundje e rëndë e ndau nga të gjithë në vitin 2016 nga bashkeshorti i saj Kolë Prel Grima duke lënë pas dy vajza dhe një djalë, Loretën, Silvanën dhe Edin, sot të mirëshkolluar në Itali e Australi, fëmijë model i veçantë për tu patur zili. Filja ishte një njeri shumë i vlerësuar dhe kështu u respektua në jetën tokësore dhe në lamtumirën e fundit.

Rrespekti i veçantë për te u konkretizua gjatë ceremonisë mortore. Kjo lamtumirë për Filen ka qenë krejt e veçantë, kishin ardhur njerëz nga vende të ndryshme. Ishte një organizim i paparë nga nxënësit e shkollave,

studentët dhe të rinjtë, në atë nivel sa prifti i Kishës në Padova u shpreh: "Qofshi të bekuar o ju Shqiptarë, pasardhësit e Kastriotëve, sepse na nderuat, kjo pjesmarrje dhe ceremoni është e veçantë dhe e paparë në kishët tona". Lulashi u tregua i fortë edhe përballë vdekjes, ashtu sikurse ishte burrë përballë faljes.

Lulash Nika shumë pasionant ishte ndër të paktët persona që ruajti kanunin e Lekë Dukagjinit në sergji në dimrin e gjatë të diktaturës. Me ardhjen e demokracisë, paragrafët e tij i përtypte. Ishte mjeshtrë i zgjidhjes së problemeve dhe mosmarrveshjeve me ndershmëri. Misioni i tij fisnik i faljes bëri shumë godi, ndaloi gjakderdhje ku u thirr si pajtimtar, në qytet e fshat si burrë i mençur. Peshorja e drejtësisë, thoshte Lulashi, nuk funksionon nese interpretimi i neneve nuk bahet me dorë në zemër. Atë e udhëhiqte parimi i mosmbajtjes anë të njërit krah dhe rëndesa e tjetrit të mos ndodhte, kjo ja zbardhte ballin atij në pajtimin e shumë dyerve të rëna në gjak. Në këto procese ishte pjekuria e mendimit dhe forca e argumentit bindës deri në shterrim. Kjo forcë mendimi e gjykimi me drejtësi e barazpeshë ishte e pamundur të kundërshtohet.

Lulash Nika u burrërua siç i ka hije një banori të lartësive, zgjodhi ndershmërinë për të harmonizuar një staturë me paraqitjen fizike që i kishte falë Zotit, ku humori e shoqëroi deri në fjalën e fundit. Misioni në pajtimin e gjaqeve është një profesion i vështirë përderisa ke të bësh me pajtim shpirtërash. Kush praktikon këtë zeje i tejkalon limitet e akademikut, profesorit apo psikologut. Me personin apo grupin e individëve ku hataja zgjeron, duhen ndarë

gëzimi dhe hidhërimi, halli dhe sherri. Plagët janë të vështira po nuk ju bane terapi në dhe kurën e nevojshme. Lulashi thoshte, se misionari duhet të durojë edhe fjalorin e ashpër të palës që ka humbur jetë njerëzore. Fati i mirë që zoti e solli në jetë ishte shumë herë më i madh sesa fati që e mori.

Duhet theksuar se ndarjen me familjen, të afërmit, fisin dhe çetën e pajtimin e konceptoi punë pak ditësh. Si një burrë stoik i papërkulur nuk shfaqti asnjë lloj dobësie në çastin e ikjes nga kjo jetë me veneracion e fisnikëri të shenjtë. U dha kurajo të gjithëve duke i bindur se jeta vazhdon dhe ka po ato ngjyra edhe kur ai t'mos jetë më në bashkinë me lule që po çelin, të jetës tokësore.

Unë do të kem ne kujtesë gjithë jetën time faktin se vetem pak orë përpara se të jepte lamtumirën e përjetshme me kujtonte episode me detaje të mardhënëve në mes nesh e sidomos të vegjëlisë dhe të rinisë time, sikur i kishte të regjistruara. Ishte përtej kufijve të imagjinatës kujtesa e pazakontë e tij kur parametrat e organeve jetësore ishin në limitet fundore të sinjalit sos.

Ishte fund shkurtit ku gjallëresat e para të bimësisë po trokitnin, dhe në këtë kohë u largua nga të gjithë vigani i bamirësisë dhe i mbidhjes së farës së mirë, po largohej vetem si trup, sepse mbrapa po linte si prikë bujarinë, zgjuarsinë, besnikërinë dhe burrërinë. Çdo çast i parapriu arsyeja e qetësisë, mirëkuptimi me malësorin ku lindi, me qytetarin ku u formua dhe me intelektualin që bashkëjetoj e bashkëpunoj.

Lulash Nika vetem fizikisht nuk është më midis nesh. Ai ishte dhe mbeti në kujtesën kolektive dhe do të jetojë për një kohë të gjatë si burrë me shumë mend. Shtëpia e tij lindi, rriti, shkolloi, fejoj e martoi pasard-

hës, nipa e mbesa të denjë për malësinë e qytetarinë. Se do të vinte një ditë se kush prej nesh e dinte. Por që të vinte në mënyrë të menjëhershme papritmas si një britmë në boshllëk pak kush prej nesh e priste. Por nisjen e udhëtimit për në qiell e mendonim më të largët, sidomos ne që e njohëm nga afër. Ishte një përcjellje me një ceremoni mortore të maturuar në çdo detaj, siç ai e meritonte dhe dëshironte ai vetë.

Lulash...! Nuk mund të them lamtumirë, për vetë faktin kokfortë se ti në vijimësi je përsëri në mes nesh si një enciklopedi e gjallë, me thëniet e urta, me batutat e sajuara në çast me plot finesë e humor të shkallëzuar dhe të kategorizuar. Lulash! Të kujtojmë për shembullin vetjak që le gjurmë dhe për virtytet që i pate me shumicë. Trungu i tyre ka shumë degë të gjelbëruara e rrema të lulëzuara nga oxhaku i hershëm i familjeve të Gjon Nik Marashit, Fran Kol Pepçit e Pjetër Njemzës me pasardhës të shumtë dhe të shpërndarë në Europë dhe përtej Atlantikut me sokola e sokolesha, secili më fisnik se tjetri me kujdesin që të përcjellin dhe të trashëgojnë ndër breza virtytet e cilësive më të mira të brezajnës.

Lulash! Për herë të fundit nuk mundem me të thanë lamtumirë, sepse ti je përsëri mes nesh. Por lamtumirën ta jap në emër të të gjithëve. Një lamtumirë e këtij dimension i shkon për shtat një njeriut me shpirt të madh, zemërgjërë, bamirës e bujar. Le të besojmë se ikja jote nuk mund të jetë një arrati pa kthim.

MARK BOBNAJ,

mjek stomatolog dhe studiues.

Shënim: Në numrin 248 e gazetës “Dukagjini”, e muajit qershor 2024, në publikimin e promovimit të librit “Flas me shpirtin tim”, të autorit Tonin Arrinaj, në fjalën e tij “Mendimi im!” janë bërë disa gabime drejtshkrimore dhe për këtë asye po e ribotojmë. Autorit të librit, z. Tonin Arrinaj, Redaksia i kërkon falje, për pakujdesinë e paraqitjes së fjalës së tij, me titull “Mendimi im!”

Mendimi im!

Tonin Arrinaj

Të dashur pjesëmarrës, njerëz të nderuar të letrave e dashamires të Artit, Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj. Keni lanë punët tuaja e keni ardhë.

Ju falënderoj me gjithë shpirtin tim!

Falënderoj ata djem, që u shprehen për librin tim.

Falënderoj Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, me kryetar zotin Ndue Sanaj dhe zonjushën Suela, moderatore.

Dua të them që ky libër, me ka ardhë lirshëm sepse të gjitha motivet i kisha të shkruara në mend.

Kam shkruar, për pjesë të jetës sime ato më mbresëlënëse.

Në ato mbresa janë vendlindja ime, Dukagjini im, Shkodra e Atdheu im.

Ato që kam ditur, që kam ditur për Dukagjinin mbi historinë e tij e traditat e tij.

Nga Dukagjini kam ikur fëmijë, por në fakt asnjëherë skam mundur të iku prej tij.

Nga Atdheu kam ikur i ri, por asnjëherë skam mundur të ndahem prej tij.

Largësia nuk të largon, prej atdheut; ndërsa Indiferenca po.

Kur isha fëmijë, më pyesnin nga jeni? Ju thosha, jam nga Dukagjini. A prej Dukagjinit jeni? - e fytyrat e tyre tregonin fatkeqësisht ironi. Më vonë kuptova që ata që ma shanin Dukagjinin ju mungonte diçka, që nuk e kishin si dukagjinasi e mi.

Sa më shumë, që ma shanin aq më shumë fillova ta dua.

Identike, më ka ndodhur me Atdheun.

Në ato vitet e para të emigrimit t'u thoshe se jam shqiptarë ishte njësoj si t'u thoshe kam kolerën.

Kuptova, që kishin diçka më pak se, ne shqiptarët e sa më shumë, që ma shanin aq më shumë fillova ta dua!

Kuptova, që ju mungonin disa gjëra në dukje të thjeshta si zemërgjerësia, respekti e vendosmëria!

Dukagjinasi!

Dukagjinasi është i vendosur. Kur vendosë të bëje diçka si për mirë dhe si për keq e banë dhe nuk pret çastin që ta bëje. Nuk thotë, do e bëj javën tjetër e pastaj javën tjetër, e bën dhe pikë...

Ketë vendosmëri e kanë më shumë shqiptarët sesa popujt e tjerë! Dalëngadalë gjërat filluan të ndryshojnë, por fal vendosmërisë sonë! Ndryshuan dhe opinionet e ngriti krye respekti.

Kuptuan që nuk jemi një popull injorantesh, por një popull me djem e vajza të talentuar e me plot pasione.

Kuptuan, që prapa paraqitjes së njerëzve të “forte” ishim një popull me mjaft dhimbshuri e me rregulla të respektit, që ata i kishin harruar.

Filluan të na duan!

Kjo gjë po ndodhë, për fat dhe me Dukagjinin. Opinionet dalëngadalë po ndryshojnë.

Kanë kuptuar që Dukagjini, nuk është një zonë që nëpërkëmbët, por është një

zonë me plot njerëz të talentuar, të dashur e me një bujari të pasqorë.

E për mua Dukagjini, është një dashuri, e më shumë se një dashuri, është një dhimbje.

Dukagjini është i dhimbshëm.

Atdheu vete, është i dhimbshëm. Më është dashur të largohem prej tyre, që ta kuptoj sa më mungojnë. Më mungojnë aq sa vetëm ata që kanë emigruar për një kohë të gjatë si unë e kuptojnë.

Të tjerët jo fatkeqësisht!

Por të vijmë tek libri: libri im ka vetëm dashuri, ka dhe kritika, por kurrë urrejtje!

Ka dashuri për Thethin, Dukagjinin, zonën time dhe për Shkodrën, qytetin tim.

Shkodra!

Shkodra, është qytet i bekuam prej Zotit, ai e ka shpall qytet të përjetshëm! E kush e ka pa e nuk e ka dashtë?

Shkodra të banë për vete!

Nuk dua të zgjatem e të them se çfarë është Shkodra. Fatkeqësisht, Shkodra ka një armik që kurrë nuk ra dakord me POLITIKËN.

Kurrë nuk ra dakord totalisht me te edhe kurrë politika nuk e deshti Shkodrën. Shkodra i ka dhanë provat e veta si ndaj Atdheut, si ndaj politikës sa askush tjetër e ka marrë nga politika, më pak se askush tjetër.

Turp për politiken!!!

Por Shkodra mbetet Shkodër, nuk ka fjalë tjetër për te.

Gjithkush e dine, se çfarë është Shkodra e çdo kush e dinë që herët o vonë, do marrin atë që meriton.

Fronin e mbretëreshës!

Ajo i ka të gjitha armët e duhura, Histori, Art, Kulturë, Sport, talente, dije dhe e bukuri. Këto janë armët e saj e do dijë si gjithmonë ti shpalosin. Fatkeqësisht as ne emigrantët kurrë nuk u ndjemë të mbrojtur nga politika.

Kurrë nuk u ndjemë të mbrojtur nga politika!!!

Por Shkodra ashtë një dashuri!

Cili emigrant kur kalon urën e Boçallekut nuk kthehet ta shohin dhe njëherë kështjellën e “Rozafës”?! Sa prej tyre e kanë pa për here të fundit, sepse nuk janë kthye më!

Në librin tim kam fole për emigracionin, për ato çka kam përjetua personalisht e kam pa tek të tjerët

Fatet e shumicës pothuajse ishin të njëjta, mall, vuajtje e fatkeqësi.

Emigrimi, më besoni ashtë një shkollë.

Në jetë provova zhgënjimin e atij, që të thoshte të dua si vëlla. Provova zhgënjimin e atij, që të thoshte kij besim tek unë. Mësova, që e vërteta me fjalët nuk bënin të njëjtin hap. Mësova, që kur jeni në hall shoqëria pothuajse nuk ekziston. Duhet, që kur të rrezohesh të çohesh vetë. Mësova, që njerëz që hiqen si të mençur mendojnë, që të tjerët janë budallenj.

Mësova, që njerëz të shkolluar ju mëso-

jnë të tjerëve injorancë dhe njerëz më me pak shkollë, ju mësojnë të tjerëve edukatë. Mësova, që ai që më fliste keq për ty, të fliste dhe ty keq për mua.

Atëherë, mësova të them, që jam mirë dhe pse kisha dhimbje në shpirt. E mësova, që ata që më ndihmuan nuk duhej ti harroja kurrë. Mësova, që fitorja më e madhe për një njeri është të mposhtin mendimet negative, veç atëherë ke njohur paqen e shpirtit!!! Mësova, që kurrë nuk duhej të harroja vendlindjen time, Dukagjinin e qytetin tim të rinisë, Shkodrën time.

Një vëlla më ka thanë se, ndoshta e

këngëtarë, valltarë e njerëz të tjerë, që kishin dëshirë të kalonin kohën me biseda, këngë e valle. Kam kenë një fëmijë kërkues dhe më pëlqenin këngët e vjetra e çdo gjë që fliste për historinë e Dukagjinit. I dëgjoja me kureshtje e mendoheja ti përsërisja me mend. Jam mundua, që ti fusja në librin tim për aq sa më kujtoheshin. A janë e njëjta gjë? Jo. Duke mos i kujtua mire jam mundua të shtjelloj idenë e atyre këngëve Por jam mundua. Këngët e librit tim janë bazuar në gojëdhëna balada e legjenda e jam krenar, që jam mundua ti përcjelli tek të tjerët, sepse për Dukagjinin është fole aq pak e është shkrua aq pak,



ke teprua me dashuri, unë i them se me dashuri pothuajse nuk teprohet kurrë, me urrejtje po. Për mua s'ka fjalë, që e shprehë dashurinë për Shkodrën, për Dukagjinin e për atdheun. Veç fjale të mira më nxjerrë shpirti e nuk di të ndalem.

Një frazë e vetme, një strofë e vetme sikur gjithë mençurinë e botës ta fusësh nuk e shprehë dot dashurinë që një emigrant si unë ka për Shkodrën e vendlindjen. E unë, duke mos e gjete atë fraze e atë strofe, jam zgjate, e jam zgjate hajt edhe një hajt edhe ketë. Nuk mendoja, që do dilte një libër kaq voluminoz, por mendoja se do dilte sa gjysma e tij. E fajin ma ka dashuria e plot malli. Asnjë qytet në botë as Napoli nuk merr aq dashuri nga qytetaret e saj sa Shkodra. Mund të jetojnë në Paris, Londër, Romë, Milano e kudo në botë, kur i pyet nga jeni dhe të përgjigjen (prej Shkodrës), e duket se heqin diçka prej shpirtit. Në ato dy fjale ka aq dashuri aq mall e krenari.

Fëmijërinë e kam kalua në Dukagjin, aty jam bërë 15 vjeç. Kam pas fatin e mirë, që shtëpinë e kulturës ta kem veç 50 m prej shtëpisë. Aty mblidheshin gjithë art-dashësit e Dukagjinit, instrumentistët,

sa nuk mund të mendohet. Kam kërkua të gjej materiale, jam mundua e kam gjetur pak, duke mos pasur mundësi të tjera, pos atyre autodidakteve kam pas vështirësi. E ata që i kanë këto mundësi i gjënë në lokale e nuk bëjnë punën e tyre. Në librin tim kam shkruar për ngjarjet historike e figurat kryesore të historisë së Dukagjinit. Kam folur për të gjithë? Jo. Do ishte e pamundur në një libër të vetëm.

Shpresoj me zemër, që dukagjinasi të tjerë ta vijnë gjithë linjën e heronjve të Dukagjinit, dhe pse janë heronj dhe pse askush se ka marr mundimin ti shpallin zyrtarisht.

Nuk mundet kurrë, që historinë e Dukagjinit ta shkruaj një person, që ka lind në Delvinë o Gjirokastrë. Duhet ta shkruajmë vete historinë tone. E për deri në luftën e Dytë Botërore kemi seç të shkruajmë ma shumë se te tjerët.

Lufta e Dytë Botërore ishte një katastrofe për historinë e Dukagjinit, duke mos u shpallë as majtas as djathtas, as me komunizmin e as me pushtuesit, në veç 4 vite humbëm 2000 vjet histori. Ramë në pus të pafund. Na bane shembull për keq. Në e Malësinë e Madhe

Këndoj se kënga më del prej shpirtit

NOEL PJETRI I RIU QË NDËRTON URA BASHKPUNIMI DHE THYEN REKORDE

Kur dielli po rrezatonte Majat e thepisuna të luginës së Shalës, kullën e Gjelosh Markut të Nanëmvriq e mbushi jehona e një djali të sapolindur. Lazer Zefin dhe gjithë familjën, Zoti e gëzoi me një djalë. Ishte fëmija i parë dhe gjyshi Zefi për të trashiguar emrin e Axhes Ndue Markut i cili nuk kishte lanë fëmijë, me mirëkuptimin e prindervë i vendosi djilait emrin Ndue - Noel. Perendimi i djellit të asaj ditë kullën e Gjelosh Markut e gjeti plot miq e dashamirë. Kanga e nisun nga gjyshi Zefi i hapi radhën festës së lindjes së Noelit.

E përmendun në malet e Dukagjinit kjo kullë për patriotizem, burri e fisnikri ku Gjelosh Marku ishte një ndër organizatorët e kryengritjes Anti-Zogiste në vitin 1924. Në përballjen e përgjakshme në Prefekturën e Shkodës me trimeri e zgjuars Gjeloshi ja numëroi me plumba në ballë Qark Komandantit të xhandarmërisë Kapiten Ferid Frashrin, i cili kishte urdhëruar dhe udhëhequr reprezaljet e kombëshme të bëra në Dukagjin me vrasje, burgosje, djegje dhe bastisje të shtëpiave. Edhe pse ai kishte mundësi të largohet e ti shpëtonte dënimin Gjeloshi për të shpëtuar familjen vendosi të dorzohet. U dënua me varje në konop, drejt të cilit shkoj duke kënduar dhe nuk pranoi të afrohet xhelati. Me ballin lart dhe me këngën që i dilte nga shpirti e dha jetë heroikisht. Ky aktë patriotik frymëzoi shumë autor këngësh për ti thurë vage. Shkrimtari Fadil Karaja në punën e tij në zonën e Dukagjinit u njohë me këtë histori dhe u frymëzua për të shkruar dramën - Besa e burrit.

Këtu zë fill kënga e cila u trashigu brez pas brezi në këtë kullë ku përmendim Ndue Markun një ndër instrumentistët më të mirë të lahutës, Zef Gjeloshi interpretues i kangës majë krahu ku përfaqësoi Shalën në shumë festivale. Mhill Kola Pjetri i cili së bashku me Mjeshtrin e Madhe Sali Mani themeluan Orkestrinën e Koplikut, ku Mhilli interpretonte shumë mirë në fyell, lahut dhe çifteli. Palë Zefi Pjetri interpretues i kangës majë krahu dhe drejtues i grupit të burrave të Dukagjinit që interpretojnë Gjamën e burrave.

Ky gen artistik u përcoll edhe sot dhe përfaqësohet denjshëm nga Noel Laz-

er Pjetri i cili i rritur më dashuri për të qënurit Dukagjinës dhe i edukuar me vlera fisnikrie e besnikrie është burim vlerash.

Duke e ndjekur folklorin Dukagjinës prej shumë dekadash jam falenderues për zemërsisht, Mjeshtrit të Madhë, Mhill Çunit i cili me ciklin "Hite Folklorike" e nxorri nga nëntoka folklorin të cilin po e zhdukte muzika orjentalë e fillimit të tranzicionit në Shqipëri.



E përsëris arsyen që vëndosa të shkruaj sot për Noelin sepsë duke e ndjekur veprimtarin e tij të sapofilluar jo veten si kushëri por edhe si dashamirëse e folklorit dua ta falenderoj për zemërsisht Noeli për ngjyrimin dashamirës që po i jep folklorit duke u paraqitur gjithnjë e më shumë me moshatarët e tij duke i nxitur të merren me Folklor. Kjo ja shton vlerën si artisti. Së pari duhet të jeshë artist në shpirt e duke mos e lejuar vetën të përfshihet nga egoja e komercializmit, Noeli ka thënë

në një intervistë tek TV 1 Channel, disa vite më parë- Këndoj se kënga më del prej shpirtit.

Ja vlen të përmendim bashkëpunimin me Daniel Pergjoka & Noel Pjetri - Lulet rriten në vend të vet- ku mesazhi i kësaj këngë është mjaftë i forte kushtuar largimit të rinjve nga trojet e të parëve.

Në moshë të re ai përfaqëson Shkodren në festivalin Komëtarë të Folklorit në Gjirokastrë dhe vazhdon të dhuroj

shumëanshme.

Faleminderit për rekordin që po vëndos ku në këtë moshë të re po i afrosh 10 milion klikimeve e për të vazhduar edhe më tej në bashkëpunim me Novi Prendin me këngën kushtuar Dodë Tahirit e cila tashmë nuk ka kufi harte, profesion apo moshë. Përsëris Noeli i cili me të drejt thotë - Këndoj se kënga më del prej shpirtit. Ky është suksesi kur arti buron nga shpirti i rritur më dashuri për

supriza të njëpasnjëshme duke e rritur audjencën e tij tashmë në miliona.

.Me plot bindje I them Noeli:

Faleminderit që po e trashigon genin artëdashës të Fisit.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe ndihmën që ju dhuron bashkëmoshatarëve.

Faleminderit që po e ruan dhe interpreton folklorin e pastër dhe por rikthen shumë këngë të harruara.

Faleminderit për urat e bashkëpunimit me të gjithë ku i dhuron ndihmën të

jetën, patriotizmin, fisnikrin dhe burrin. Suksesi është gjithmonë në rritje.

Dukagjini e dukagjinasi janë përfaqësuar dhe do përfaqësohen gjithmonë nga njerëz të thjeshtë por që e jetojnë jetën me shpirt plot dashuri.

Noelit edhe një herë I themi faleminderit. Të këndohet Zemra dhe suksese paqë gjithëmonë.

ROZA PJETRI

veç arma na e pat majtë në krye të vendit dhe kur i ulëm armët kaluan mbi ne ata që nuk i njihje kush.

Historinë tonë e shkruan të tjerët, sipas qejfit të tyre. Ata ngritën në qiell historinë e tyre. Banë heronj deri ata, që i vranë vetë me dorën e tyre. E as Dukagjini e as Malësia e Madhe pothuajse nuk kishin ma heronj. Kjo, më ka bërë të flas me shpirtin tim.

Përmbi 60 vjet dëgjua sa e sa këngë për heronjtë e tyre të rremë e histori të rreme. Të gjithë kemi dëgjua këngën Martaneshi vend i mirë, s'duron Pashë s'duron Vezirë. Atëherë unë kam thane, kur Martaneshi krahina ma fetare e Shqipërisë s'paka durua Pashë e Vezirë çka duhet të shkruaj unë për Dukagjinin tim? Më

lindi dëshira të fus në librin tim këngën e 7 shaljanëve. Ashtu siç e kanë këndua shaljanët, secilit prej tyre një për një, sepsë ashtu jua kërkonte ligji i pashkruar, i nderit familjar dhe pse ajo më shumë, se një këngë është një baladë e gjatë e dimrave të ftoftë ashtu siç është këndua në Dukagjin. Kënga e 7 shaljanëve është më se e vërtetë, sepsë ka dëshminë e Deli Pjetërës, që e mohoj e ama, e mohoj dhe Dukagjini, për ata tashmë ishte i vdekur. U kthe në Shkodër me vdekë dhe ai si Hero. Të gjithë kemi dëgjua këngën e Hajredin Pashës ... "Jo ma pak se 12 mijë kanë metë në istikame e në Dhe s' kanë hi". **Pra, di-branët paskan vra 12 mijë turq. Ata 12 mijë dele sikur ti kishin vra do i kishte zan gjaku. Më falni, por mua më duket**

diçka e paarsyeshme.

Vetëm në luftën e Nikçit, Shala, Shoshi e Kelmendi shpartalluan një ushtri prej 8 mijë trupash turke, nisë nga Peja në drejtim të Shkodrës. Mbeti veç statistikë në arkivat e shtetit. Asnjë këngë, asnjë mburrje dhe pse u lame me gjak grykat e Nikçit. E kush ishte si Dukagjini para luftës së Dytë Botërore, askush. Dukagjini ndihmoi jo veç Kelmendin, por dhe Malësinë e Madhe si në kodra të Moksetit, në Daçiq, në Tuz, në mbrojtje të Plavës e Gucisë, shkuan në ndihmë të Krasniqes e të Mic Sokolit. E kush e ndihmoi Dukagjinin? Askush! Kush e ndihmoi Dukagjinin, në qafën e Agrit? Askush! Po në qafën e Boshit, në Plan-Gjuraj, në Tëtherme, në Gurë të Kuq e në qafën e Kolçit? Askush!

I doli zot vetes e nuk e ndjeu nevojën të mburrej e quajtën thjesht dëshirë, për mbrojtjen e dinjitetit shqiptar.

Asnjë mburrje!

E s'po flasim për të tjera si marrja e kështjellës "Rozafa". O hyrja në Tiranë, që e detyroj Zogun të largohet përkohësisht nga Tirana.

As dhe një mburrjeje, këna gabua?!

Duhej dhe ne të rrihim gjoksin. Këna gabua?! E pra, këto janë të vërteta historike! Rendësi ka që Dukagjini, me djemtë e bijat e tij të talentuar ta shkruajnë historinë e tyre, disa prej të cilëve janë këtu e na nderojnë.

Unë besoj tek ju!

Besoj në ata që vijnë pas nesh!

Ju falemi ndërse!

*** Poezi nga Gjyste Çarku - Bici *** Poezi nga Gjyste Çarku - Bici ***

Moj e bukra bardhe si bore

Moj e mira ca po m'thue
Doren n'zemer ven per mue
Hije t'paska kjo xhublet
Aspak shtir spata met gjet
Permi tana ,m'paske dal
Kacurrelat vin vale,vale

Kur ke dal asaj fushe
Thac me veti je harush
At buljer ne krah garkue
M'ep pak uje per mem freskue
Prej dors tane uje me pi
Met shpreh lirshem ket dashni

Vet'lla syni e hieshia
Dej mi kan ment e mia
Aj shikim mka kaplue
Hapi kraht mem perqafue
T'lidhim bashk na ket kunor
Moj e bukra bardhe si bore

Shtegut rrugs tuj kalue
Lshova gurin met nalue
Kur t'munohesh per me hjek
Vi t'nimuj se kam lshue vet
Te dy bashk shkamin largojm
Per'gjithmon zemrat bashkojm

Teksti:
Gjyste Çarku Bici Maj/25/2023

Nanat tona fisnike

Nanat tona fisnike t' mdha
Jo n'kto male si gje ma
Jet'ne tyne si è kan kalue
Asht pak shtir per me tregue
Tana hallet si vet jeta
Ato kjen zana t'verteta

Me u cue heret me lidh qenin
Mren me u kthye,me shi venin
Pa zbardh drita i kan pru drut
Me kuq votren e me pjek buk
N'shpin e mueren ate buler
Rrug's tuj ec tuj ba gjypner

Teshat la n'lang hi ahit
Bardh si bora rrethit gardhit
Rrah me les ferkue me dore
S'ankuen kurre se jena lodhe
Buken n'strajc djepin en shpin
Furken n'bres mrapa bagtin

Rraz cetins djepin me p'shtet
Me kang zogjsh me vu me fjet
Drejt konakut,gjan mej cue
Mjelcen n'dor en shtrung me v'nue
Mar i kan marre tetana punt
Xan me shqil djathin n'lpung

Se shpiakve u ka pas hie
Mish ferlik,djathin tue zie
Nanat tona shkurt i pan fjalt
Cka lan miqt kan pas darke
Edhe n'kjoft se ska met gja
Kan shtre brit e skan ba za

Pak prej munit fjalt jau mlodha
En g'juh t'maleve une e shkrova
Per mej majt me faqe t'bardhe
Me dit mire se ka kem ardhe
Historia e ka vertetue
Sikur burra n'luft kan shkue

Teksti:
Gjyste Çarku Bici, 6/19/2024

Prej N'breg t'detit en orteg t'bors

Athue line vec per mue
Rruth e struk mori sy shkruie
Le ta din tetan mahalla
Ket dashni anerr si n'pralla
Vrahesh amel syt mi lshon
Bregu detit kur kalon

S'kam marre zemer per met nal
Vitet ikin dal ,kadal
Peshkatar jam dale me g'juh
Ta qes rrjeten pa vonue
Sikur njal po ma sjell shtatin
Ske ka shkon,por nale vrapin

Nalu pak,ma shtrej ate dore
Shtat selvi e bardhe si bore
kur po me qesh mori sy shkruie
I thom val's ty met kaplue
Neper uje pak met t'ret
Me not vi et xierri vet

Ata flok kunor ,kunor
Ti p'shtjelloj tuj prek me dore
Nuk kam ardhe me ba gara
Djali i zemres t'del perpara
Hajde t'shkojm na dora dors
Prej n'breg t'detit N'orteg t'bors

Hapi kraht sikur shqiponja
Nate e dite per ty menova
Se kur t'biesh en kraht e mi
Ta kam shpreh t'amlen dashni
Det e bjeshke na mej shijue
Tlumtun jeten me kalue

Teksti:
Gjyste Çarku Bici Maj/27/2023

Nje muze qe ec ne rruge:

Rruez gjylpan me ken krejt malet
N'simbol t'shkruemit dora s'nalet
Tana shkrolat per mej knue
Ska teftet qe i zen mej shkruie
Lugjet tua sa vet jeta
Sipat kush sikur xhubleta

Nje muze qe ec ne rruge
Universi i shkruem ne rruez
Em'na te mllej,firma c'do kohe
Pacarelat e krejt ksaj bote
Ty xhublet ta kan zili
Je mretnesha e ksaj shqipni

Tirq, xhublet, kapuc i bardhe
Na e thon rrugen ka kem ardhe

N'logje dazma tuj hjell valle
Shqipja t'ruen mare en kto male
Luf'na dallge,kudo je nesh
Miljon breza ty t'kan vesh

Lis e shkam goje me pase
Me marre dijet mare dynjas
N'breza tu bardhe e zi
Rruez e spik kan histori
N'pem e lule ku shkoj blea
Tana t'shkrueme i ka xhubleta

N'ty jan shkruie hana e dielli
Rruga e jetes dhe ylberi
Univers edhe blet
N'ty xhublet u shkruie kjo jete
Sa vet kreshtat en kto male
Kan met ruejt Alpet shqiptare

Teksti:
Gjyste Çarku Bici korrik/11/2024

Bijat en gjini

Pak rreshta jam tuj shkruie
Vetem pak sa meu ra n'vesh
Me lezet me jau kujtue
Per meu ba pak me qesh

Lodhet shpia thone per bia
Nata shkon gjumi s'na merr
Ham e pim si te gjinia
Kem ba qef por s'jena dej

Kena ardhe meu vizitue
Jo turista me u lan lek
Aman shumë mos me u trishtue
Gjithe e cilla shkon n'shpi t'vet

Jo s'rrim shume vec me kujtue
Si e kaluem na rinin
E kur t'nisna meu garkue
Kshtu kan than gjith'mon per bin

Shkojm en troje ku na dha baba
Rrim sojnikë si rrin bia
Zduem me lan na sherre mrapa
Jo zduem toke per me ba shpia

Doke zakone sa vet jeta
Kurre nuk duhet me i harrue
N'Dukagjin ç'asht e verteta
Burre e toke t'dyja skan shkue

Teksti:
Gjyste Çarku Bici Theth 9/9/2024

Ktu fillon em'ni shqipni

Sa her malet kange kan nise
N'tel t'Lahuts e t'Çiftelis
Sa her shnrinis diell e han
E kan shkruie e kan me than
Mi kto troje te lavdis
Ku nis em'ni i shqip'nis

Me naq shpirtin e me shue mallin
Vargje fjalsh prej zemre dalin
Prej n'Qaf t'Pejs, Puke e Mirdit



Naj njuh bota Historit
Ato ane kush i ka m'sy
Erdh me kam e u kthye pa krye

Qysh me t'part e Dukagjinit
En kto troje te kshtenimit
Dukagjin,Puke e Mirdit
Per ket toke heroi kan rrit
Per liri ner e flamur
Kurre kto male sjan perkul

Amaneti i lan prej t'parit
Tja perciell mali malit
Gjithkun flitet fjala nane
Bit e shqipes kudo jan
Vllaznit tone matan kufinit
Me i forcue kraht e bashkimit
REFRENI
Bese e ner e bujari
N'Dukagjin i ke n'cdo shpi
Jan tradita t'gdhen ne gure
Shale e Shosh,Nikaj,Mertur
Puke,Mirdit e n'Male t'Hotit
Gjak i paster i Kastriotit

Teksti:
Gjyste Çarku Bici Gusht 2023

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Suela Ndoja,
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin
REDAKSIA